

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORTI VJETOR 2024

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| SHKURTIME DHE TERMINOLOGJIA | 4 |
| I. KORNIZA LIGJORE | 5 |
| II. MESAZHI I KOMISIONERIT DHE VIZIONI | 6 |
| III. E DREJTA PËR INFORMIM | 9 |
| III.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE | 9 |
| III.1.1 Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë..... | 11 |
| III.1.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësisive të Vetëqeverisjes Vendore | 12 |
| III.2 TRAJTIMI I ANKESAVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT..... | 13 |
| III.3 TË DHËNAT E HAPURA, RIPËRDORIMI I INFORMACIONIT PUBLIK DHE KONSULTIMI PUBLIK | 16 |
| III.3.1 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e të dhënave të hapura | 18 |
| III.3.2 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e konsultimit publik..... | 19 |
| III.4 RAPORTIM I AUTORITETEVE PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT | 20 |
| III.5 REGJISTRI ELEKTRONIK I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË PORTALIN PYETSHTETIN.AL | 22 |
| IV. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE | 23 |
| IV.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA..... | 23 |
| IV.2 BASHKËPUNIMI ME EUROJUST | 24 |
| IV.3 TRAJTIMI I ANKESAVE | 25 |
| IV.4 HETIMI ADMINISTRATIV | 25 |
| IV.4.1 Hetime administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit | 26 |
| IV.4.2 Hetime administrative pranë kontrolluesve të tjerë | 28 |
| IV.4.3 Raport mbi zbatimin e detyrimeve nga kontrolluesit publikë..... | 29 |
| IV.5 VENDIMMARRJA | 29 |
| IV.5.1 Rekomandime Unifikuese..... | 30 |
| IV.6 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR | 31 |
| IV.7 REGJISTRI I NJOFTIMEVE..... | 31 |
| V. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË KONTEKSTIN E BRENDSHËM | 32 |
| V.1 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E SHQIPËRISË | 32 |
| V.1.1 Zbatimi i Rezolutës | 32 |
| V.1.2 Roli i institucionit në veprimtarinë e Kuvendit..... | 33 |
| V.2 PËRPUTHSHMËRIA E AKTEVE RREGULLATORE ME LEGJISLACIONIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE | 33 |
| VI. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE | 35 |
| VI.1 PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN | 35 |
| VI.1.1 Udhërrëfyesit | 35 |
| VI.1.2 Dokumenti i Anëtarësimit: Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian..... | 35 |

| | |
|---|-----------|
| VI.1.3 Progres Raporti i Komisionit Evropian..... | 35 |
| VI.1.4 Raportime periodike në kuadër të procesit të integritimit..... | 36 |
| VI.2 PJESEMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE | 37 |
| VI.2.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit | 37 |
| VI.2.2 Zyra e Komisionerit zgjidhet anëtare në Grupin e Specialistëve të Konventës 205 të Këshillit të Evropës | 41 |
| VI.2.3 Këshilli i Evropës vlerëson zbatimin e Konventës 205 nga Shqipëria | 41 |
| VI.2.4 Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit Shqipëri-Azerbajxhan | 41 |
| VI.2.5 OECD ftoi Zyrën e Komisionerit për të ndarë eksperiencën në fushën e të drejtës për informim | 42 |
| VI.2.6 Takimi i punës së shqyrtimit të rasteve të veçanta “Për të drejtën e informimit”..... | 42 |
| VI.2.7 Asambleja Globale e Privatësisë (GPA)..... | 42 |
| VI.2.8 Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale | 43 |
| VI.2.9 Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB)..... | 43 |
| VI.2.10 Samiti Vjetor i Privatësisë, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë IAPP | 44 |
| VI.2.11 Bordi Mbikëqyës për Mbrojtjen e të Dhënave të EUROCONTROL | 45 |
| VI.2.12 Pjesëmarrje në forume të tjera | 45 |
| VII. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE | 46 |
| VII.1 AKTIVITETET NDËRGJEGJËSUESE DHE DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE | 46 |
| VII.2 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE | 50 |
| VIII. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE | 52 |
| VIII.1 AKTE RREGULLATORE | 52 |
| VIII.1.1 Miratimi i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” | 52 |
| VIII.1.2 Udhëzimi nr. 463/2020..... | 53 |
| VIII.2 DOKUMENTE STRATEGJIKE | 53 |
| VIII.2.1 Strategjia Institucionale 2022-2025 | 53 |
| VIII.2.2 Plani i Integritetit 2022-2025 | 54 |
| VIII.2.3 Strategji Ndërsektoriale..... | 55 |
| VIII.3 PROCESE GJYQËSORE | 56 |
| VIII.3.1 Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” | 56 |
| VIII.3.2 Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar | 57 |
| IX. MENAXHIMI BUXHETOR..... | 58 |
| IX.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE | 58 |
| IX.2 MENAXHIMI I BUXHETIT | 59 |
| IX.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET | 60 |
| IX.4 AUDITIME..... | 60 |

SHKURTIME

TERMINOLOGJIA

| | |
|---|---|
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| AP | Autoritet Publik |
| BE | Bashkimi Evropian (European Union) |
| Direktiva e Policisë | Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” |
| GDPR | Rregullore (BE) nr. 2016/679 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” (General Data Protection Regulation) |
| GPA | Asambleja Globale e Privatësisë – Global Privacy Assembly |
| ICIC | Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioner) |
| KiE | Këshilli i Evropës (Council of Europe) |
| Ligji për të drejtën e informimit (LDI) | Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar |
| Ligji për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik | Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” |
| Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale | Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” |
| Ligji nr. 49/2022 | Ligji nr. 49/2022, datë 12.05.2022, “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (Konventa 108+)” |
| Ligji nr. 45/2022 | Ligji nr. 45/2022, datë 28.04.2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumenta zyrtare (Konventa 205)” |
| NjVV | Njësi të Vetëqeverisjes Vendore |
| OSHC | Organizata të Shoqërisë Civile |
| PT | Programi i Transparencës, tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të ligjit "Për të drejtën e informimit” |
| REKPDI | Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit |

I. KORNIZA LIGJORE

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është person juridik publik dhe autoriteti mbikëqyrës i pavarur dhe përgjegjës për monitorimin e mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve përkatëse, sipas fushave të përgjegjësisë, që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale, të drejtën e informimit, si dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Veprimtaria e institucionit bazohet në kuadrin ligjor të mëposhtëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 23 garanton të drejtën për informim dhe neni 35 garanton mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9288/2004 “Për ratifikimin e Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”;
- Ligji nr. 49/2022 “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
- Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i ndryshuar;
- Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”;
- Ligji nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”;
- Ligji nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

II. MESAZHI I KOMISIONERIT DHE VIZIONI

Raporti vjetor që ju paraqitet, ndërthur funksionet konsultative, rregullatore, vendimmarrëse, kontrolluese dhe advokuese të Komisionerit, tenton të ofrojë objektivat dhe realitetin për një mbrojtje vërtet të integruar për të dhënat e çdo personi, ashtu si nga ana tjetër konsolidimin e detyrimit të Autoriteteve Publike për të dhënë llogari për veprimtarinë e tyre duke i shëndërruar skutat e errëta të administratës në mure prej xhami krejtësisht të depërtueshme nga rrezet e transparencës.

Transparenca e veprimit administrativ është një shtyllë e sistemit tonë demokratik, një instrument i qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme.

Të qenit të informuar dhe të ndërgjegjshëm për aktivitetet e administratës publike na bën protagonistë aktivë të jetës publike, kontrollues efektivë të përdorimit korrekt të burimeve, mbështetës të sigurt të institucioneve.

Dhe mund ta bëjmë këtë, me angazhimin e vazhdueshëm të stafit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ende i kufizuar në numër, që meriton zgjerim proporcionalisht me detyrat në rritje të institucionit, por me një rritje të shpejtë të aftësive profesionale, të kualifikuar, të cilin dëshiroj ta vlerësoj dhe falënderoj për përballimin e sfidave gjatë vitit 2024.

Falënderoj të gjitha institucionet, duke filluar nga Kuvendi që kanë mbështetur dhe synuar të na ofrojnë, në mënyra të ndryshme, bashkëpunimin e tyre.

Duhet nënvizuar miratimi i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafëruar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), ndërsa zbatimi i tij, përbën sfidën më të madhe në drejtim të garantimit të standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.

Ngjarje e rëndësishme për Zyrën e Komisionerit ka qenë organizimi në Tiranë i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Në vlerësim të kontributit, vendit tonë ju besua edhe presidenca e Komitetit Drejtues të Konferencës.

Bashkëpunimi institucional, marrëdhënia e vazhdueshme me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, medias, botës akademike, sinergjia e formave të ndryshme të mbrojtjes së të drejtave që ofrohen, bashkëpunimi ndërkombëtar, ndjenja e lartë e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave që i janë besuar Komisionerit, lejojnë një perspektivë largpamëse të nevojshme për të kuptuar, edhe para rregullimit, një realitet në evolucion të vazhdueshëm si ai dixhital.

Zyra e Komisionerit do të vijojë të jetë laborator i mendimit, formimit dhe forcimit të kapaciteteve profesionale për stafin e saj, koordinatorët dhe nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave, nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme në dialog të sinqertë dhe të hapur.

Vetëm duke parë përtej horizontit, ne mund të mbrojmë në fakt të drejtat, siç është e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe e drejta për informim, të ndërgjegjshëm që ndodh në dialektikë të vazhdueshme me evolucionin teknologjik.

Në fund të fundit, është shikimi largpamës ai që duhet të ketë të drejtën të jetë në gjendje të rregullojë një të ardhme, *i cili hyn tek ne, për t'u shndërruar në ne, shumë përpara se të ndodhë.*

ALBANIA

ICIC XV

"I wanted to thank you again for your wonderful, warm hospitality and congratulate you on a very successful ICIC Conference event. Your entire staff should all be given extra applause (and even a day off!) for all of the hard work they clearly put in to bring together over 200 participants for great discussions on a number of important topics."

"Much appreciation goes to you and your team for wonderful hospitality accorded to us and excellent management of the conference. We believe the conference was very successful and all the members have been benefited from this conference. Growing but beautiful city of Tirana and Kruja and many other places, which we could explore within short period of time. Mountains and some places look similar to our country. We loved the place. Regards and thank you again."


"It was an extremely interesting discussion and experiencing, Albania was very special!"

"Thank you very much to the IDP Albania and the entire XV ICIC organisation team – it was an amazing event in a beautiful country!"

"On behalf of the FOI Philippines, we'd like to congratulate Commissioner Besnik Dervishi and the rest of the team for the successful hosting of ICIC. I must say it was a very well organized and sincere conference."

"Our XV ICIC Edition was a great success.

We thank the member authorities, cooperation partners, and our host for this edition IDP Albania, for making this gathering possible, focused on strengthening the promotion and guarantee of access to information worldwide."



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

STATISTIKA VJETORE

1396
ANKESA

247

REKPGDI

355

KOORDINATORË

441

DPO

44 VENDIME

45 REKOMANDIME

84 SEANCA
DËGJIMORE

DHËNIE MENDIMI

64 AKTE LIGJORE / NËNLIGJORE

40 OPINIONE

130

INSPEKTIVE NË TERREN

III. E DREJTA PËR INFORMIM

III.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE

Monitorimi i publikimit proaktiv të informacionit përfshin mbikëqyrjen dhe vlerësimin sistematik të përpjekjeve të autoriteteve publike për të informuar qytetarët, në përputhje me dispozitat ligjore, nëpërmjet publikimit të informacionit në programin e transparencës në faqet e tyre zyrtare.


Gjatë ushtrimit të funksioneve tona mbikëqyrëse, është konstatuar se në tërësi autoritetet publike janë të ndërgjegjësuar për rëndësinë e informimit të qytetarëve dhe përditësimit të informacionit sa herë që ai pëson ndryshime, por mbetet ende punë për t'u bërë dhe përpjekje të vazhdueshme për të gjithë administratën për të arritur standardet e nevojshme.

Progres është konstatuar edhe në raportin e fundit të Monitorimit të SIGMA-s “Administrata publike në Shqipëri 2024, Vlerësimi kundrejt Parimeve të Administratës Publike”, ku theksohet se:

“Administrata publike e Shqipërisë ka bërë përparim në krijimin e një kuadri të fortë ligjor për aksesin në informacion me kontributin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që ka treguar efektivitet në sigurimin e trajtimit të plotë të kërkesave për informacion. Komisioneri ka treguar efektivitet në trajtimin e ankesave kundër refuzimit të autoriteteve publike për vendosjen në dispozicion të informacionit. Megjithatë, ka vend për të përmirësuar sa takon aksesit për informacion, pasi autoritetet publike shpesh u përgjigjen kërkesave vetëm kur kërkesit i është dashur të paraqesë një ankesë te KDIMP”.

Zyra e Komisionerit në kuadër të detyrave dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, gjatë gjithë vitit 2024, ka vijuar monitorimin e programeve të transparencës të publikuar në faqen zyrtare të të gjitha autoriteteve publike, si dhe monitorimin e publikimit dhe përditësimit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Monitorimi përfshin të gjitha autoritetet publike të pushtetit qendror, përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e varësisë, sistemin e drejtësisë, pushtetin vendor si dhe institucione të tjera si shoqëri aksionare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, IAL-ve, si dhe urdhrat profesionalë. Gjatë vitit 2024, ka pasur rritje të numrit të autoriteteve publike, krahasuar me një vit më parë. Kjo për shkak të ristrukturimit të disa prej tyre, si edhe krijimit me ligj të autoriteteve të reja publike. Duke qënë se gjatë vitit të kaluar ka patur autoritete të krijuara rishtazi, Zyra e Komisionerit ka pasur në fokus të punës së saj monitorimin e transparencës proaktive edhe në këto autoritete. Konkretisht, Komisioneri ka dalë me 25 Rekomandime lidhur me vënien në zbatim dhe publikimin/përditësimin e informacionit në programin e transparencës të këtyre institucioneve, të cilat mund të konsultohen në faqen zyrtare <https://idp.al/rekomandime-2024-ddi/>.

Në total gjatë vitit 2024 janë monitoruar 355 autoritete publike, ku rezulton se në secilin prej tyre është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit dhe të dhënat e tyre janë përditësuar dhe në portalin pyetshtetin.al. 331 autoritete publike kanë publikuar programin e transparencës dhe e kanë përditësuar me informacion, ndërsa regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është përditësuar nga 318 autoritete.



Zyra e Komisionerit përveç kryerjes së monitorimeve online, ka zhvilluar gjithashtu edhe hetime administrative pranë këtyre institucioneve publike. Konkretisht, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 15 procese hetimi administrativ me objekt: *Konstatimin e kundërvajtjes për mungesën e krijimit, mbajtjes, publikimit apo përditësimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve*. Në konkluzion të procedurave të mësipërme administrative, për ato autoritete publike të cilat nuk kishin marrë masa për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme ligjore, ose nuk kishin njoftuar Zyrën e Komisionerit për pengesa të qenësishme në mospërmbushjen e këtij detyrimi, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e 12 seancave dëgjimore. Në përfundim të procesit të hetimit administrativ dhe rimonitorimit, rezultoi se 4 autoritete publike nuk arritën të përmbushin detyrimin ligjor. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit doli me 4 vendime urdhërimi për krijimin, mbajtjen, bërjen publike dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, si dhe u dha sanksion administrativ “gjobë” personave përgjegjës, sipas përcaktimeve ligjore.

Gjatë vitit 2024, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar dhe 12 inspektime pranë autoriteteve publike me objekt:

- Përmbushja e detyrimit për vënien në dispozicion të publikut në faqet e tyre në internet, të kategorive të informacionit, që bëhen publik pa kërkesë, referuar nenit 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
- Përmbushja e detyrimit për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës sipas Urdhrit nr.187/2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e programit model të transparencës, të rishikuar”, i ndryshuar.
- Përmbushja e detyrimit për caktimin e Koordinatorit për të drejtën e informimit referuar pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
- Përmbushja e detyrimit për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar nenit 8 dhe shkronjës b), të pikës 2, të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit nr. 188/2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, për ato autoritete publike të cilat nuk kishin marrë masa për zbatimin e programit të transparencës ose nuk kishin njoftuar Zyren e Komisionerit për pengesa të qenësishme në mospërmbushjen e këtij detyrimi, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e 5 seancave dëgjimore. Nisur nga inspektimet dhe seancat dëgjimore të kryera, si dhe gjendja e transparencës proaktive në momentin e monitorimit të faqes zyrtare, autoriteteve publike iu është vënë në dukje gjendja e zbatimit të programit të transparencës dhe iu është lënë një afat i dytë për realizimin e mangësive të evidentuara. Në përfundim të afatit të lënë nga Zyra e Komisionerit, autoritetet publike janë rimonitoruar, ku në total për 14 prej tyre u evidentua angazhimi i tyre për përmirësimin e transparencës proaktive dhe plotësimin e informacionit në programet e transparencës, ndërsa 3 autoritete publike në përfundim të vitit kalendarik vazhdojnë të jenë ende në proces shqyrtimi administrativ.

Gjithashtu, bazuar në Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Programi Model i Transparencës për Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2019, Zyra e Komisionerit ka dërguar pranë 61 njësive të vetëqeverisjes vendore, shkresë zyrtare për rishikimin e programit të transparencës, i cili duhet të bëhet nëpërmjet së njëjtës procedure, përmes së cilës bëhet miratimi. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por në asnjë rast nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.

Nga ana tjetër, në përfundim të monitorimit vjetor, për të pestin vit radhazi, Zyra e Komisionerit hartoi 2 indekset e transparencës për Institucionet Qendrore e të Varësisë dhe ato të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, me qëllim matjen e transparencës proaktive.


III.1.1 Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

U verifikua niveli i transparencës proaktive në 251 institucione qendrore: “Institucione Qendrore” (përfshirë institucionet kushtetuese, të pavarura dhe ato qendrore të krijuar me ligj të veçantë) “Institucionet e varësisë”, “Institucione të Sistemit të Drejtësisë”, (të ndarë në gjykata dhe prokurori), si dhe “Institucione të tjera” (përfshirë IAL, sh.a. etj). Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 12 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 12 (dymbëdhjetë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi, llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilin institucion.

- *Publikimi i programit të transparencës;*
- *Publikimi i strukturës së autoritetit publik;*
- *Publikimi i funksioneve dhe detyrat e autoritetit publik;*
- *Publikimi i Cv-së së titullarit;*
- *Publikimi i legjislacionit;*
- *Të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;*
- *Publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (psh. raporte KLSH ose raporte Audit të Brendshme);*
- *Publikimi i të dhënave për buxhetin, për vitin financiar 2024;*
- *Publikimi i regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik, për vitin 2024;*

- *Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2024;*
- *Lista e shërbimeve që ofron AP;*
- *Lista dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes.*

Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se 112 autoritete publike qendrore dhe të varësisë janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër, 111 autoritete publike janë klasifikuar me transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë; 26 autoritete publike janë klasifikuar me transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë; 2 autoritete publike janë klasifikuar me transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe.



112 autoritete publike me nivel transparence të lartë ose 45%.

111 autoritete publike me nivel transparence të mjaftueshme ose 44%.

26 autoritete publike me nivel transparence të ulët ose 10%.

2 autoritete publike me nivel transparence të pamjaftueshme ose 1%.

Në krahasim me gjetjet e vitit të kaluar, mund të veçohet rritja e transparencës tek autoritetet publike me semafor të gjelbër nga 38% në vitin e kaluar në 45% për këtë vit, çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga të gjithë vitet e kaluara, në transparencën proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë.


III.1.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në këtë monitorim janë përfshirë 61 njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashki) dhe 12 Këshillat e Qarkut. Për matjen e transparencës së Këshillave të Qarkut janë përdorur kryesisht të njëjtët indikatorë të përdorur për të matur transparencën e Institucioneve Qendrore dhe të varësisë. Në monitorimin e kryer për Njësitë bazë të Vetëqeverisjes Vendore (bashki) është përdorur sistemi i matjes së 12 treguesve kryesorë, të cilët janë renditur më poshtë:

- *Publikimi i programit të transparencës;*
- *Publikimi i strukturës;*
- *Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak;*
- *Publikimi i Cv-së së titullarit;*
- *Publikimi i legjislacionit;*
- *Të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;*
- *Publikimi i raporteve të auditimit të KLSH-së;*
- *Publikimi i PBA 2024 -2026/buxhetit 2024;*
- *Publikimi i Paketës Fiskale 2024;*
- *Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2024;*

- *Shërbime në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;*
- *Koordinatori për konsultimin me publikun.*

Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se 30 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër, ndërsa 30 institucione të njësisive të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë; 13 njësi të vetëqeverisjes vendore janë renditur me transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë; asnjë njësi e vetëqeverisjes vendore nuk është klasifikuar me transparencë proaktive shumë të ulët, pra në semafor të shënohet me dritë të kuqe.



30 NjVV me nivel transparence *të lartë* ose 41%.

30 NjVV me nivel transparence *të mjaftueshme* ose 41%.

13 NjVV me nivel transparence *të ulët* ose 18%.

0 NjVV me nivel transparence *të pamjaftueshme* ose 0%.


Në krahasim me gjetjet e vitit të kaluar, vërehet rritje e transparencës tek Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me semafor të gjelbër nga 29% në vitin e kaluar në 41% për këtë vit, çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga të gjithë vitet e kaluara, në transparencën proaktive të autoriteteve publike të njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Të dy këto raporte gjenden të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit dhe mund të konsultohen në lidhjen: <https://idp.al/raporte-monitorimi/>.

III.2 TRAJTIMI I ANKESAVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të së Drejtës për Informim në Zyrën e Komisionerit për vitin 2024 administroi 939 ankesa, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 86 procedurave të mbartura nga viti 2023 (gjithsej 1025 ankesa). Këto shifra tregojnë rënie të lehtë të numrit të ankesave për 2 vitet e fundit, që mund të lidhet dhe me tendencën e përmirësimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Konkretisht, ndaj 61 Njësisive të Vetëqeverisjes Vendore u depozituan 332 ankesa dhe ndaj Autoriteteve Publike të tjera 607 ankesa. Rezulton se edhe për këtë vit pesha specifike e ankesave për mosdhënie të informacionit vijon të anojë nga NJVV në raport me AP-të e tjera.




Referuar të dhënave të administruara, për aq sa mund të identifikohen, ankesat e paraqitura janë grupuar në tre kategori, sipas tabelës së mëposhtme.

| Ankuesit | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 |
|----------|-----------|-----------|-----------|
| Qytetarë | 343 | 367 | 393 |
| OSHC | 196 | 171 | 181 |
| Gazetarë | 456 | 395 | 365 |


Nga totali prej 1025 ankesash, për 623 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve gjatë zhvillimit të procesit të shqyrtimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit.

Ndërkohë, institucioni është shprehur me 23 vendime për 23 ankesa. Nga këto, janë dhënë 11 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 5 vendime rrëzimi, 2 vendime mospranimi dhe 4 vendime me sanksion administrativ, gjobë. Me ndryshimet e ligjit “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka dalë me 1 vendim duke sanksionuar titullarin e Autoritetit Publik për mos zbatimin e vendimit të Komisionerit.



Grupet e interesit apo qytetarët edhe këtë vit e përqendruan kërkimin e informacionit bazuar në ngjarje të aktualitetit të cilat lidhen me fondet e buxhetit të shtetit, sistemin e shëndetësisë, kontratat konkensionare, prokurimet publike, mjedisin, planifikimin e territorit, kontrollin e ushqimeve, etj. Rrjedhimisht edhe vendimmarrja e Komisionerit për këtë vit ka qenë e fokusuar në këto fusha specifike. Ndërkaq, 204 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit të ligjit, kryesisht për çështje me natyrë individuale, ose që trajtohen nga ligje të tjera specifike. Nga hetimi administrativ konstatohet se ka një përmirësim në kuptueshmërinë e LDI-së nga kërkuesit e informacionit, por, duke qenë se me legjislacionet specifike nuk arrijnë të zgjidhin çështjet konkrete ato i drejtohen institucionit të Komisionerit si institucion i pavarur me qëllim adresimin e problematikave. Ky fakt duhet të nxisë akoma edhe më shumë shtimin e përpjekjeve/formave ndërjegjësuëse për qartësimin e ndryshimit mes një kërkesë për informacion publik dhe asaj me karakter personal, kërkesë për dhënie mendimi, apo për prononcim mediatik (intervistë).

Gjithashtu, rezultojnë 14 ankesa të refuzuara bazuar në kufizimet e ligjit, 100 ankesa të paraqitura jashtë afatit, 25 të paplota, si dhe 36 të tjera të mbartura për shqyrtim në vitin 2025. Si pjesë e procesit të shqyrtimit administrativ për ankesat e depozituara, u zhvilluan 26 inspektive pranë autoriteteve publike dhe 30 seanca dëgjimore.



Ndër problematikat kryesore të konstatuara nga Zyra e Komisionerit gjatë shqyrtimit të ankesave përmendim:

- i. Autoritetet Publike gjatë këtij viti kanë ngritur vazhdimisht shqetësimin e kërkesave voluminoze dhe të shtrira në një hark kohor të gjatë, të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe staf shtesë për t'i trajtuar. AP në kushtet që ndodhen nuk arrijnë t'i përmbushin në kohë detyrimet që burojnë nga LDI.
Zyra e Komisionerit ka mirëkuptuar në çdo kohë vështirësitë e hasura për shkak të kërkesave voluminoze apo mungesës së stafit, por nuk ka përjashtuar në asnjë moment AP nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë në lidhje me transparencën.
- ii. Paqartësi nga Autoritetet Publike në lidhje me të drejtën e autorit të subjekteve, të cilët marrin pjesë në një procedurë administrative. Këto raste nuk trajtohen në përputhje me parashikimet e nenit 17 apo legjislacionit specifik që rregullon të drejtën e autorit.
- iii. Në kontratat publike vazhdojnë të parashikohen dispozita konfidencialiteti për informacionin/dokumentacionin që lidhet me to.
Pavarësisht këshillimit nga ana e Zyrës së Komisionerit nëpërmjet arsyetimeve të detajuara (në vendime, kërkesa për parashtrime, gjatë seancave dëgjimore apo trajnimeve të ndryshme) lidhur me pabazueshmërinë e argumenteve të ofruara për refuzimin e dhënies së informacionit, në shumë raste qëndrimi i autoriteteve publike të evidentuara si problematike ka vijuar të mbetet i njëjtë.
- iv. Kërkuesit depozitojnë kërkesa me objekt të përgjithshëm dhe megjithë ndihmën e ofruar nga Autoritetet Publike, mbetet i pa mundur identifikimi i informacionit të kërkuar.
- v. Kërkuesit vijnë të përdorin dispozitat e ligjit përtej objektit dhe qëllimit të tij për çështje/praktika administrative me karakter individual, si: akses në të dhënat personale, dokumentacioni lidhur me lejet e ndërtimit, pronësia, procedurat e rekrutimit, etj.
- vi. Vijnë ankesat nga avokatët dhe disa qytetarë, për akses në dokumentacionin e njehsuar, i cili shërben si provë në procese gjyqësore, duke anashkaluar në këtë mënyrë ligjin për avokatinë, apo Kodin e Procedurave Administrative.
- vii. Vijnë kërkesat në formën e pyetjeve apo prononcimeve në media drejtuar autoriteteve publike/titullarëve në tejkallim të qëllimit të ligjit.

III.3 TË DHËNAT E HAPURA, RIPËRDORIMI I INFORMACIONIT PUBLIK DHE KONSULTIMI PUBLIK

Të dhënat e hapura stimulojnë inovacionin, duke hequr pengesat për qasjen, përdorimin dhe ndarjen e të dhënave. Të dhënat e hapura përfshijnë çdo gjë, nga informacioni qeveritar, statistikat publike, deri tek të dhënat shkencore, hulumtuese dhe të tjera. Koncepti i të dhënave të hapura synon të promovojë transparencën, inovacionin dhe përdorimin e efektshëm të informacionit për të zgjidhur probleme dhe për të përparuar shoqërinë.

Të dhënat e hapura luajnë një rol kritik në promovimin e transparencës, nxitjen e inovacionit, përmirësimin e vendimmarrjes, fuqizimin e qytetarëve, përmirësimin e shërbimeve publike, nxitjen e bashkëpunimit dhe promovimin e barazisë dhe përfshirjes. Duke zhbllokuar vlerën e

të dhënave dhe duke i bërë ato të aksesueshme për të gjithë, të dhënat e hapura kontribuojnë në krijimin e shoqërive më transparente, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.

Të dhënat e hapura/Open Data është një koncept që përcakton të dhënat që janë të lira për t'u përdorur, përpunuar dhe shpërndarë nga të gjithë pa kufizime të ndonjë lloji. Me qëllim vendosjen e rregullave për lehtësimin e ripërdorimit të dokumenteve ekzistuese të mbajtura nga organet e sektorit publik është miratuar ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili është përafruar me Direktivën (BE). Ky ligj përcakton kuadrin ligjor për të dhënat e hapura, bazuar në parimet kyçe të transparencës dhe konkurrencës së ndershme.

Ligji ka hyrë në fuqi nga prilli i vitit 2023, duke plotësuar kuadrin rregullator të fushës së të drejtës për informim, nga këndvështrimi i përparimit teknologjik dhe digjitalizimit të shërbimeve, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien.

Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për promovimin e ripërdorimit të të dhënave të hapura në vendin tonë, duke nxitur më tej inovacionin në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve publike me standarde të larta. Miratimi i këtij ligji mundëson gjithashtu ripërdorimin nga qytetarët dhe grupet e interesit të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik, ose sipërmarrjet publike.

Me hyrjen në fuqi të këtij akti, Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve, si dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave për moszbatimin e këtij ligji. Në zbatim të kësaj kompetence, Zyra e Komisionerit ka vijuar edhe përgjatë vitit të kaluar aktivitetet ndërgjegjëse me autoritetet publike në lidhje me detyrimin për publikimin e dokumenteve/të dhënave që ato publikojnë në faqet e tyre zyrtare si të dhëna të hapura, referuar fushës së tyre të veprimtarisë, gjë që sjell lehtësi për publikun për gjetjen dhe ripërdorimin e tyre. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për të bërë, si në aspektin e ndërgjegjësimit, ashtu dhe në përgatitjen apo standardizimin e dokumenteve në formatin e duhur për ripërdorim.

Në funksion të plotësimit të kuadrit ligjor për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, Zyra e Komisionerit do të ofrojë bashkëpunimin e saj ndaj institucioneve përgjegjëse për plotësimin prej tyre, të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr. 33/2022, datë 31.03.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar trajnimeve me personat e caktuar si persona kontakti për të dhënat e hapura për publikimin në faqet zyrtare të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike të listës së dokumenteve që ofrohen si të dhëna të hapura si dhe mënyrës së trajtimit të kërkesave për ripërdorim. Komunikimi dhe shkëmbimet me grupet e interesit dhe qytetarët do të vijojnë të jenë në fokus të aktivitetit të Zyrës së Komisionerit, ashtu si edhe trajnimet për njohjen e kuadrit të ri ligjor për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Sa i përket zhvillimeve teknologjike, garantimi i cilësisë së të dhënave është një proces kritik dhe thelbësor për suksesin e politikës së të dhënave të hapura. Zyra e Komisionerit do të punojë

në këtë drejtim me organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në drejtim të rritjes së kapaciteteve institucionale të strukturës përgjegjëse për të dhënat e hapura të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike për zbatimin efikas të këtij ligji.

III.3.1 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e të dhënave të hapura

Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Një nga karakteristikat e të dhënave të hapura referuar në nenin 11 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” është se “ripërdorimi i dokumenteve është i hapur ose sipas kushteve të licencës”. Qëllimi i licencës për të dhënat e hapura është të ofrojë siguri juridike që të dhënat që janë objekt i licencës mund të përdoren lirisht nga të gjithë në çfarëdo mënyre të mundshme, me kushtin kryesor që burimi i të dhënave të përmendet në mënyrën e kërkuar në licencë.

Në zbatim të nenit 11 dhe nenit 22 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka përfunduar procesin e hartimit të Udhëzimit “Për licencën standarde për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” i cili është nënshkruar nga Ministri dhe Komisioneri dhe ka hyrë në fuqi me botimin në fletoren zyrtare në shkurt 2025.

Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” fut konceptin e kategorive të të dhënave me vlerë të madhe, të përcaktuara si të dhëna që janë të lidhura me përfitime të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë kur ripërdoren. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit ka miratuar aktin nënligjor, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 444 datë 03.07.2024 “Për shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe”. Ky akt vjen në zbatim të pikës 2, të nenit 16 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Akti nënligjor i miratuar vjen në përputhje me Rregulloren e Komisionit Evropian 2023/138/BE, datë 21 dhjetor 2022, e cila përcakton një listë të grupeve specifike të të dhënave dhe masave me vlerë të lartë për publikimin dhe ripërdorimin e tyre, duke realizuar një përafrim të pjesshëm të kësaj Rregulloreje.

Për realizimin e përafrimit të plotë të këtij akti, si dhe në përmbushje të detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Zyra e Komisionerit është duke koordinuar punën me organet publike përgjegjëse për çdo kategori të dhënash me vlerë të madhe, për hartimin e akteve nënligjore për përcaktimin e grupeve specifike të këtyre të dhënave.

Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit mbi zbatimin efektiv të kuadrit të modernizuar ligjor.

Në muajin Tetor ka filluar bashkëpunimi i Zyrës së Komisionerit dhe projektit “Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë”. Pjesa e parë e këtij projekti, tetor 2024 – janar 2025, i dedikohet zbatimit efektiv të ligjit nr. 33/2022. Zyra e Komisionerit po bashkëpunon me

ekspertët e këtij projekti me qëllim hartimin e materialeve të kërkuara në kuadër të implementimit të këtij ligji nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike si dhe organizimi i trajnimeve në vijim.

Ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike mbi zbatimin e kuadrit të ri rregullator të fushës

Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2024 ka bashkëpunuar me organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për zbatimin e ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Gjatë këtij viti është komunikuar me 214 institucione, nga të cilat 153 janë organe të sektorit publik dhe sipërmarrje publike dhe 61 njësi vendore/bashki, me qëllim përmbushjen e detyrimit kryesor të këtij ligji, publikimin e “Listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura.” Në vijim të këtij procesi, referuar paqartësive dhe përgjigjeve të kthyer nga organet e sektorit publik është vendosur komunikimi dhe ofrimi i mbështetjes dhe asistencës me këto institucione, me qëllim realizimin e publikimit të dokumenteve të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike si të dhëna të hapura.

III.3.2 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e konsultimit publik

Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt-akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik. Konsultimi publik është mekanizmi që mundëson përfshirjen e publikut, grupeve të interesit, biznesit, komunitetit akademik, ekspertëve dhe medias në vendimmarrje duke siguruar përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit të politikëbërjes, me qëllim krijimin e politikave me cilësi të lartë në përmbajtje dhe që reflektojnë nevojat e shoqërisë e sigurojnë zhvillim.

Ligji nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” në nenin 21 parashikon mbrojtje administrative në rast cënimi të të drejtave të parashikuara nga ky ligj. Kur projekt-akti është miratuar pa u respektuar të drejtat e parashikuara nga ligji, ky i fundit ka parashikuar mundësinë e mbrojtjes ligjore administrative. Sipas ligjit palët mund të ankohen pranë vetë institucionit që zhvilloi procesin e konsultimit dhe pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në varësi të fazës në të cilën ndodhet procesi i ankimit.

- Palët mund të ankohen brenda institucionit nëse akti nuk është miratuar ende.
- Palët mund të ankohen pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditëve nga data e miratimit të tij.

Gjatë vitit 2024 pranë Zyrës së Komisionerit janë paraqitur 2 ankesa bazuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në trajtimin e ankesave bazuar në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nuk ka të drejtë të marrë vendime administrative, duke përfshirë dhe

vendosjen e masave disiplinore apo gjobave, por i është dhënë thjesht një rol rekomandues ndaj organit publik përgjegjës.

III.4 RAPORTIM I AUTORITETEVE PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Bazuar në nenin 24/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, “Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave. Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri”.

Ky rregullim i shërben kontrollit që Komisioneri ushtron mbi autoritetet publike, evidentimit të problematikave për zbatimin e ligjit, si dhe rritjes së përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Bashkëpunimi i autoritetit publik me Komisionerin përbën një nga aspektet më të rëndësishme në drejtim të garantimit të së drejtës për informim dhe përmbushjen e qëllimit të ligjit.

Zyra e Komisionerit miratoi Urdhrin nr. 209, datë 13.12.2024 “Për Miratimin e Formatit të Raportimit të Autoriteteve Publike për Vitin 2024 “Mbi Zbatimin e Kërkesave të ligjit për të Drejtën e Informimit”.

Me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi, gjatë muajit janar 2025, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë të gjithë koordinatorëve për të drejtën e informimit formularin e raportimit të të dhënave të kërkesave për informacion të marra gjatë vitit 2024.

Në tabelën më poshtë janë të dhënat e mbledhura nga Zyra e Komisionerit në bazë të vetëdeklarimeve të bëra nga autoritetet publike.

| | |
|---|-------|
| Nr. total i Autoriteteve Publike | 355 |
| Nr. i Autoriteteve që kanë raportuar | 351 |
| Nr. total i kërkesave për informacion publik, regjistruar në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve periudha janar - dhjetor 2024 | 11549 |
| Kërkesa nga gazetarë ¹ | 3129 |
| Kërkesa nga përfaqësues të shoqërisë civile ² | 1540 |
| Kërkesa të deleguara tek një Autoritet tjetër | 611 |
| Kërkesa që kanë marrë përgjigje të plotë | 9289 |
| Kërkesa të refuzuara | 191 |
| Kërkesa që kanë marrë përgjigje të pjesshme/të kufizuar | 688 |

Në rastet e përgjigjeve të refuzuara ose të pjesshme/kufizuara, të dhënat e raportuara lidhur me shkaqet ligjore të kufizimit/refuzimit të dhënies së informacionit janë si më poshtë:

¹ Për aq sa mund të identifikohen.

² Për aq sa mund të identifikohen.

| | |
|---|-----|
| Të drejtën për një jetë private | 43 |
| Sekretin tregtar | 20 |
| Të drejtën e autorit | 7 |
| Patentat | 1 |
| Sigurinë kombëtare | 27 |
| Parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale | 88 |
| Mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor | 3 |
| Formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit | 3 |
| Barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor | 9 |
| Këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike | 22 |
| Mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare | 6 |
| Të tjera | 162 |

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet se kemi një rritje të numrit të autoriteteve publike të cilat kanë raportuar pranë Zyrës së Komisionerit lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Ky fakt reflekton një rritje të ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të autoriteteve publike me Zyrën e Komisionerit. Rezulton se ka një ulje të numrit të kërkesave për informacion nga 12323 kërkesa të deklaruara për vitin 2023 nga 304 autoritete publike, në 11549 kërkesa për informacion të deklaruara për vitin 2024 nga 351 autoritete.

Në raportimin e vitit 2024, një kërkesë e re e Zyrës së Komisionerit ishte evidentimi i kategorisë së kërkuesve të informacionit, ku për vitin 2024 rezulton se 3129 kërkesa për informacion janë bërë nga gazetarë dhe 1540 kërkesa për informacion janë bërë nga përfaqësues të shoqërisë civile.

Autoriteteve publike, nëpërmjet formatit të pyetësorit iu la mundësia të shpreheshin edhe nëse ndryshimet e fundit ligjore të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, specifikisht lidhur me përgjegjësinë e çdo personi, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, kishin ndikuar në trajtimin më shpejt të kërkesave për informacion dhe dhënien e përgjigjeve sa më të plota, ku nga shumë përgjigje rezulton se ndryshimet ligjore lidhur me përgjegjësinë administrative kanë patur ndikim pozitiv në trajtimin më shpejt të kërkesave për informacion dhe dhënien e përgjigjeve sa më të plota.


Zyra e Komisionerit nëpërmjet raportimit u kërkoi autoriteteve publike të shpreheshin edhe mbi nevojat e tyre lidhur me udhëzime apo trajnime të ndryshme nga ana e kësaj zyre, nevoja të cilat do të adresohen përgjatë vitit 2025.

III.5 REGJISTRI ELEKTRONIK I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË PORTALIN PYETSHTETIN.AL

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDİ), i integruar në portalin pyetshtetin.al sipas VKM-së nr. 145/2018, mundëson ushtrimin e së drejtës për informim me kërkesë dhe eventualisht të ankesës pranë Zyrës së Komisionerit. Kjo mënyrë siguron përfshirjen e drejtpërdrejtë të koordinatorit dhe garanton gjurmueshmërinë e procesit, duke mos lënë hapësira për abuzim dhe/ose shmangie të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Në vitin 2024, u realizua instalimi i REKPDİ në 25 autoritete të reja, duke e çuar në 247 numrin e AP-ve. Janë zhvilluar paralelisht trajnime të rregullta me koordinatorët për mënyrën e përdorimit të tij. Nëpërmjet tij janë dërguar nga qytetarët dhe grupet e interesit 208 kërkesa për informacion, ndërsa janë paraqitur 18 ankesa pranë Zyrës së Komisionerit.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI-n ka vijuar punën për mirëmbajtjen e shërbimit të kërkesës për informacion nëpërmjet e-albania. Ky sistem është funksional për 163 autoritete publike dhe i vjen në ndihmë qytetarëve për të marrë informacione me karakter publik, nëpërmjet kanalit unik qeveritar.



IV. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

IV.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

Në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar, mbrojtja e të dhënave dhe respektimi i privatësisë janë bërë çështje të rëndësishme për individët, bizneset dhe shtetet, pasi teknologjia vazhdon të evoluojë dhe të prekë çdo aspekt të jetës tonë të përditshme. Me rritjen shumë të madhe të të dhënave që krijohen nga individët e bizneset, mbrojtja e informacionit personal në Shqipëri, si dhe në nivel global, është bërë prioritet. Për këtë arsye, ruajtja e privatësisë dhe siguria e të dhënave janë pjesë e pandashme e zhvillimeve teknologjike dhe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në besimin e përdoruesve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Mbrojtja e të dhënave personale, sipas legjislacionit i referohet praktikave, politikave dhe proceseve të krijuara për të mbrojtur të dhënat personale nga keqpërdorimi, humbja, qasja e paautorizuar ose ekspozimi. Ndërsa kontrolluesit dhe individët ndajnë dhe ruajnë të dhëna online, ata ekspozojnë të dhëna personale, financiare apo dhe shëndetësore (sensitive) ndaj një sërë rreziqesh. Sigurimi i masave të forta mbrojtëse për të dhënat është thelbësor për të parandaluar vjedhjen e identitetit, mashtrimet dhe shkeljet që mund të shkaktojnë cënimin e besueshmërisë, pasoja financiare dhe dëmtimin e imazhit.

Privatësia në teknologji lidhet me aftësinë e individëve për të kontrolluar të dhënat e tyre personale, përfshirë mënyrën se si ato mblidhen, ruhen dhe përdoren. Me rritjen e varësisë nga platformat online, mediat sociale etj., volumi i të dhënave personale që përpunohet është i jashtëzakonshëm. Kjo krijon nevojën për politika të qarta mbi privatësinë dhe masa sigurie për të shmangur mbledhjen dhe shfrytëzimin e paautorizuar të të dhënave.

Në këtë kontekst, është thelbësore që çdo kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale/sensitive, të kuptojë rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave, të njohë të drejtat që ka ligji për privatësinë dhe të zbatojë praktika të sigurt dhe të përgjegjshme për përpunimin e të dhënave personale.

Ndërsa teknologjia vazhdon të transformojë peizazhin global dhe kombëtar, rëndësia e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave nuk mund të nënvlerësohet. Palët e interesuara si individët, subjektet tregtare, etj., duhet të bashkëpunojnë për të siguruar që informacioni personal të mbrohet përmes politikave efektive, inovacioneve teknologjike dhe rritjes së angazhimit për të ruajtur privatësinë në fushën digjitale. Investimi proaktiv në sigurinë e të dhënave, si dhe ndjekja e legjislacionit dhe udhëzimeve të mbrojtjes së të dhënave, jo vetëm që zvogëlon rreziqet, por gjithashtu promovon një mjedis të sigurt për zhvillimin e teknologjisë në Shqipëri.

Zhvillimet teknologjike dhe përpunimi i të dhënave nëpërmjet shërbimeve digjitale, shkojnë paralelisht edhe me miratimin e ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në Shqipëri, i përafuar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e Policisë, i cili ka për qëllim të ofrojë një kornizë të qartë dhe të sigurt për mbrojtjen e të dhënave personale, duke siguruar që ato të mblidhen, përpunohen dhe ruhen në përputhje me standardet ndërkombëtare.

IV.2 BASHKËPUNIMI ME EUROJUST

Në zbatim të nenit 19 të Marrëveshjes me Eurojust, Zyra e Komisionerit, në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, mbart detyrimin për shkëmbime të rregullta të pikëpamjeve me institucionin e Eurojust, lidhur me gjendjen e zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe zhvillimet e mëtejshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së të dhënave. Për këtë qëllim palët (Zyra e Komisionerit dhe DPO i Eurojust) raportojnë të paktën një herë në vit mbi gjendjen e zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit zhvilloi procesin monitorues pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm (Tiranë, Elbasan, Lezhë) dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), me fokus njohjen e proceseve përpunuese të të dhënave personale, evidentimin e nivelit të zbatimit të detyrimeve në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe marrjen e masave paraprake për përmirësimin e mangësive, në zbatim të detyrimeve të Marrëveshjes me Eurojust.

Në përmbyllje të këtij procesi monitorues, Zyra e Komisionerit ka hartuar Raportin Vjetor Monitorues drejtuar Eurojust *“Mbi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust, në lidhje me zbatimin e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale”*, për vitin 2023.




Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, ratifikuar me ligjin nr. 113/2018, datë 20.12.2018, duke pasqyruar situatën aktuale lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat e marra dhe strategjitë e përdorura në mbështetje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e sigurisë, mbrojtjen dhe privatësinë e të dhënave të përpunuara nga sistemi i prokurorisë gjatë shkëmbimit të informacionit me Eurojust.

Vlen të theksohet se ky raport është realizuar për herë të parë nga Zyra e Komisionerit, i është dërguar Eurojust-it, prej të cilit është mirëpritur dhe vlerësuar pozitivisht, si dhe është evidentuar nga ana e Komisionit Evropian në Akademinë e Mbrojtjes së të Dhënave në Bruksel, si një nga praktikatat e mira që reflektojnë punën e bërë nga Republika e Shqipërisë.

IV.3 TRAJTIMI I ANKESAVE

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar 455 ankesa nga qytetarë/subjekte të të dhënave, nga shqyrtimi i të cilave, objekti i tyre kategorizohet si më poshtë:

- Cënimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (akses/korrigjim dhe fshirje);
- Përhapja e të dhënave personale pa pëlqimin e subjektit të të dhënave personale;
- Përpunimi i të dhënave në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme;
- Përhapja të dhënave personale në media dhe portale online;
- Vendosja e kamerave në ambiente publike dhe private;
- Marketing i drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike;
- Tejkalimin e afatit të mbledhjes së të dhënave personale për një qëllim të caktuar.




Bazuar në këto të dhëna, rezulton se për këtë vit, numri i ankesave 455 të ardhura në adresë të Komisionerit është në trend të ndjeshëm rritës, krahasuar me një vit më parë, ku u regjistruan 394 ankesa, çka tregon rëndësinë që po i kushtojnë individët kontrollit dhe mbrojtjes së të dhënave të tyre personale.

IV.4 HETIMI ADMINISTRATIV

Gjatë vitit 2024, janë ushtruar hetime administrative në kontrollues publikë dhe privatë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre përpunuese në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në total, u zhvilluan 77 hetime administrative, prej të cilave 10 mbi bazë ankese dhe 67 me iniciativën e Zyrës së Komisionerit (*ex-officio*). Sa i përket sferave të veprimtarisë, 44 procese hetimi administrativ u ndërmorën në kontrollues publik dhe 33 në kontrollues privat.

77 Hetime Administrative



IV.4.1 Hetime administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2024, jemi angazhuar në zhvillimin e proceseve të hetimit administrativ në disa drejtime kryesore:

- *Zbatimi i detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në fusha e sektorë si ai i arsimit, shëndetësisë, turizmit, sistemi bankar etj;*
- *Për masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale (SMSI);*
- *Për zbatimin e rekomandimeve të lëna më herët;*
- *Pranë prokurorive për zbatimin e legjislacionit të fushës dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit me Eurojust.*

Zbatimi i detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në fusha e sektorë si ai i arsimit, shëndetësisë, turizmit, sistemi bankar

Në sektorin e arsimit, u zhvilluan 20 hetime administrative në kontrollues publik (16) dhe privat (4) me objekt, zbatim i ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në përfundim, Zyra e Komisionerit ka dalë me 4 Rekomandime; si dhe Rekomandim Unifikues mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale për kontrolluesit e arsimit të mesëm të lartë.

Në sektorin shëndetësor, u zhvilluan 16 hetime administrative në kontrollues publik. Në përfundim të tyre, Komisioneri ka dalë me Rekomandim Unifikues mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale në qendrat shëndetësore dhe qendrat e specialiteteve.

Në sektorin e turizmit, u zhvilluan 6 hetime administrative, kryesisht në kontrollues privat. Në përfundim të tyre, Komisioneri ka dalë me 6 Rekomandime.

Hetime administrative me objekt tematik mbi zbatimin e masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale

Vëmendja e Zyrës së Komisionerit, është fokusuar në zhvillimin e hetimeve administrative mbi domosdoshmërinë e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).

- Në sektorin e shërbimit të teknologjisë u zhvilluan 5 hetime administrative, veçanërisht për SMSI-të. Në përfundim, Komisioneri ka dalë me 3 rekomandime si dhe 2 vendime.
- Në sektorin bankar janë zhvilluar 2 hetime administrative me fokus masat tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI). Hetimet kanë përfunduar në terren, duke mbartur vendimmarrjen përfundimtare në vitin pasardhës.

Nga kjo veprimtari mbikëqyrëse, Zyra e Komisionerit konstatoi problematika serioze në drejtim të marrjes së masave të domosdoshme tekniko-organizative për kryerjen e proceseve përpunuese, me ndikim thelbësor për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale:

- Kontrolluesit nuk disponojnë Rregullore specifike “Për përpunimin, mbledhjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”;
- Kontrolluesit nuk disponojnë strategji ose plan për SMSI, që përfshin të gjithë komponentët e një sistemi të kompletuar për menaxhimin e sigurisë së informacionit;
- Kontrolluesit nuk informojnë qartësisht subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të tyre (përmes faqes zyrtare, apo formularëve të ndryshëm që aplikojnë, përdorimin e CCTV, etj.) personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë ata, apo afatin e mbajtjes së të dhënave;
- Kontrolluesit nuk kanë marrë masat e duhura për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave që përpunohen;
- Kontrolluesit nuk kanë të parashikuar një afat konkret të ruajtjes së të dhënave personale;
- Kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për njoftim dhe/ose përditësim pranë Zyrës së Komisionerit, sa herë që shtohen proceset përpunuese apo kategoritë e të dhënave personale;
- Kontrolluesit nuk parashikojnë detyrime në përputhje me normat përkatëse ligjore në rastet e delegimit të proceseve përpunuese te palë të treta (në cilësinë e përpunuesit);
- Kontrolluesit nuk i kushtojnë vëmendje domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve/punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese;
- Kontrollues publik (në sektorin e arsimit) në përdorimin e të dhënave personale për shkak të veprimtarisë së tyre, nuk respektojnë masat e sigurisë në këtë proces, veçanërisht, në drejtim të komunikimeve elektronike nga adresat individuale të punonjësve;
- Publikimi i fotove/videove të nxënësve në rrjetet sociale të marra gjatë mësimimit apo aktiviteteve kulturore e sportive, kryhet në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e tyre.

Hetime në kuadër të Monitorimit të zbatimit të masave të lëna në Rekomandimet/Urdhrat e mëparshme

Janë realizuar 11 hetime administrative në kuadër të verifikimeve të zbatimit të 34 rekomandimeve të dhëna në periudhën 2022-2024, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private. Në tërësi konstatohet se një numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore dhe në afatet e përcaktuara, çka përbën tregues të ndërgjegjësimit në rritje për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Në përfundim, 8 kontrolluesve u

është vendosur sanksion administrativ, për mospërbushje të detyrimeve të lëna në rekomandimet e mëparshme, të tilla si, marrja e masave për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, marrja e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave, etj.

Hetime pranë prokurorive për zbatimin e legjislacionit të fushës dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit me Eurojust.

Sikurse u sipërpërmend, Zyra e Komisionerit zhvilloi procesin e parë paraprak monitorues pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë, si dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me fokus njohjen e proceseve përpunuese të të dhënave personale, evidentimin e nivelit të zbatimit të detyrimeve në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e mangësive, me qëllim zbatimin e detyrimeve të marrëveshjes.

Në përmbyllje të këtij procesi monitorues, Zyra e Komisionerit hartoi 5 raporte monitorimi një drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë, si dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), ku u evidentuan konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse mbi marrjen e masave konkrete në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të prokurorisë, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes me Eurojust.

IV.4.2 Hetime administrative pranë kontrolluesve të tjerë

Në bazë të kompetencave që Komisionerit i burojnë nga legjislacioni për masat shtesë të sigurisë publike dhe legjislacioni për kontrollin kufitar sa i përket të dhënave të pasagjerëve PNR/API, u zhvilluan 2 hetime administrative, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Njësisë së Informacionit të Pasagjerit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit, hartoi një raport vlerësimi për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, mbi zbatimin dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në kuadër të masave shtesë të sigurisë publike, si dhe një raport vlerësimi pranë Njësisë së Informacionit të Pasagjerit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, mbi zbatimin dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të përpunimit të të dhënave të pasagjerëve PNR/API. Ky është një proces me rëndësi të veçantë, i lidhur ngushtë me mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara për identifikimin e pasagjerëve, me qëllim shmangien e përpunimit të paligjshëm të të dhënave të pasagjerëve dhe garantimin e sigurisë së tyre gjatë proceseve përpunuese.

Në qendrat dhe organizatat pritëse të viktimave të trafikimit (OJF), u zhvilluan 2 hetime administrative, mbi zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit të të dhënave personale. Në përfundim të tyre, Komisioneri ka dalë me 2 rekomandime.

IV.4.3 Raport mbi zbatimin e detyrimeve nga kontrolluesit publikë

Zyra e Komisionerit, me qëllim monitorimin/mbikëqyrjen dhe zbatimin e detyrimeve ligjore i është drejtuar me shkresë lidhur me *zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale*”, 45 kontrolluesve publik, ku ndër pyetjet kryesore lidhen me masat e sigurisë teknike-organizative, aksesit i databazave, marrja e masave për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e SMSI, ndërveprimi i sistemeve, trajnimet, etj.

Nga deklaratimet e 32 institucioneve publike, në cilësinë e kontrolluesve, Zyra e Komisionerit vlerëson se problematikat e konstatuara në institucionet e administratës publike, lidhen me mungesën e njohurive ligjore dhe teknike mbi detyrimet që parashikon legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Referuar raportimeve mbi përmbushjen e masave respektive nga ana e institucioneve publike, rezulton se:


- 44% e kontrolluesve publik janë shprehur se *kanë hartuar dhe miratuar akte të brendshme/rregullatore* lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale;
- 16% e kontrolluesve publik kanë deklaruar se *kanë përcaktuar rregulla* mbi mënyrën e ndërveprimit me baza të tjera të të dhënave;
- 25% e kontrolluesve publik kanë deklaruar se *marrin masa mbi nivelet e aksesit*, garantimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollin e veprimeve të personave/personelit që ka akses në të dhënat personale;
- 28% e kontrolluesve publik janë shprehur se *respektojnë parimin e mjaftueshmërisë* për të gjithë informacionin që publikohet në faqen zyrtare si dhe ndaj të dhënave të përhapura me palët e treta;
- 25% e kontrolluesve deklarojnë se *delegojnë procese përpunimi dhe ndërmarrin masa për sigurinë e tyre*, por në asnjë rast nuk është specifikuar ekzistenca e një kontrate ku të parashikohen detyrimet e cituara në nenin 20 të Ligjit dhe në Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 12% e kontrolluesve janë shprehur se *kanë marrë masa për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e SMSI* për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 16% e kontrolluesve kanë deklaruar se *kryejnë trajnime të vazhdueshme dhe të përshtatura të personelit*, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

IV.5 VENDIMMARRJA

Në zbatim të detyrimeve ligjore, për qartësimin e rrethanave dhe fakteve në lidhje me të gjitha proceset administrative të kryera, u zhvilluan 37 seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve. Seancat dëgjimore janë zhvilluar në respektim të të drejtës së subjekteve për t’u dëgjuar në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në shifra përmblledhëse, për vitin 2024 Komisioneri u shpreh me:

- 17 Rekomandime Specifike dhe 3 Rekomandime Unifikuese;
- 16 Vendime që korrespondojnë me 48 sanksione administrative gjobë;
- 2 Urdhra (*për korrigjimin e të dhënave personale*);



IV.5.1 Rekomandime Unifikuese

Nisur nga përvoja pozitive e Rekomandimeve Unifikuese të Komisionerit, edhe këtë vit, është vijuar me dhënien e rekomandimeve të kësaj natyre në këta sektorë:

- ***Rekomandim në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme***

Në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Zyra e Komisionerit, ka realizuar hetime administrative për mbikëqyrjen e proceseve përpunuese nga Kontrolluesit në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim verifikimin e respektimit të parimeve dhe kriterëve ligjore si dhe me fokus të veçantë masat teknike dhe organizative për përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI).

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit doli me një Rekomandim Unifikues nr. 02, datë 26.03.2024 “*Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme*”, ku u evidentuan problematikat e gjetura gjatë hetimeve administrative dhe u përcaktuan detyrimet që duhet të zbatohen nga kontrolluesit lidhur me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

▪ **Rekomandim në sektorin e arsimit të mesëm të lartë**

Zyra e Komisionerit, realizoi hetime administrative për mbikëqyrjen e proceseve përpunuese nga Kontrolluesit publikë dhe privatë në sektorin e arsimit të mesëm të lartë, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji. Në përfundim, Zyra e Komisionerit doli me një Rekomandim Unifikues nr. 07, datë 07.05.2024 “*Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale për kontrolluesit e arsimit të mesëm të lartë*”.

Një kujdes i posaçëm i kushtohet të dhënave personale të fëmijëve/nxënësve nën 18 vjeç (të mitur), për të shmangur pasojat e rënda që mund të vijnë për shkak të publikimit online të të dhënave të tyre si dhe nga aksesimi ose përhapja e këtyre të dhënave nga persona të paautorizuar, në mënyrë të paligjshme.

▪ **Rekomandim për qendrat shëndetësore dhe qendrat e specialiteteve**

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e këtij sektori, nisur nga veçoria e të dhënave personale dhe sensitive që përpunohen, por edhe si rezultat i digjitalizimit dhe ofrimit të shërbimeve në sistemin e kujdesit shëndetësor. Si rezultat, përmbushja e detyrimeve ligjore sipas përcaktimeve të legjislacionit specifik, ka sjellë dhe nevojën për një vëmendje të shtuar nga ana e Zyrës së Komisionerit, në kuadër të garantimit të përpunimit të ligjshëm, sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit dhe respektimit e parimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave mbi garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.

Pas hetimeve administrative Zyra e Komisionerit ka dalë me aktin Rekomandim Unifikues nr. 08, datë 02.09.2024 “*Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale në qendrat shëndetësore dhe qendrat e specialiteteve*”, ku janë evidentuar disa problematika në lidhje me zbatimin e detyrimeve të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nga kontrolluesit, kryesisht në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit, masat teknike e organizative, sigurinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

IV.6 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR

Zyra e Komisionerit ka trajtuar 12 raste kërkesash për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, drejt vendeve që nuk kanë një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave. Në çdo rast, kontrolluesit janë udhëzuar për zbatimin e plotë të kuadrit rregullator për të garantuar përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale të individëve, kur kërkohet kryerja e këtij procesi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pas vlerësimit, është dalë me 1 vendim për lejimin e transferimit ndërkombëtar në sektorin bankar.

IV.7 REGJISTRI I NJOFTIMEVE

Gjatë vitit 2024, në përmbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar për përpunimin e të dhënave personale 53 subjekte kontrolluese të reja. Gjithashtu, u regjistruan deklaratat e 35 kontrolluesve

për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin i Subjekteve Kontrolluese në total është 6007.

Me miratimin e ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, detyrimi i kontrolluesve për të njoftuar mbi përpunimin e të dhënave personale nuk ekziston më duke qenë se tashmë kontrolluesit udhëhiqen nga “*parimi i përgjegjshmërisë*” për të qenë në përputhje me detyrimet që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka propozuar ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 144/2018 Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “*Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese*”. Duke pasur një regjistër ekzistues dhe infrastrukturë të ngritur, ku përfshihen të dhëna, është sugjeruar që regjistri aktual, të përdoret dhe përditësohet, për identifikimin e nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave në zbatim të përkufizimit të ligjit të ri. Qëllimi i ndryshimit të VKM-së, lidhet me faktin e kthimit të kësaj databaze nga një bazë të dhënash për identifikimin e kontrolluesve, në identifikimin e Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO) në Republikën e Shqipërisë.

V. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË KONTEKSTIN E BRENDSHËM

Zyra e Komisionerit, si institucioni përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit që garanton zbatimin e dy të drejtave dhe lirive themelore, angazhohet në mënyrë konstante dhe ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe institucionet e tjera të administratës publike/shtetërore në vend. Ky ndërveprim është i rëndësishëm jo vetëm në konsolidimin e kulturës së komunikimit administrativ, por veçanërisht, në arritjen e objektivave të autoritetit në të dy fushat kryesore të përgjegjësisë.

V.1 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E SHQIPËRISË

V.1.1 Zbatimi i Rezolutës

Procesi i raportimit vjetor në Kuvend përfundoi me miratimin e “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023”. Institucioni ligjvënës ka vlerësuar punën dhe arritjet në plotësimin e objektivave të Zyrës së Komisionerit, duke lënë edhe rekomandimet përkatëse për vitin pasardhës 2024, të cilat janë përmbushur plotësisht gjatë këtij viti.

Për fushën e të drejtës për informim, rekomandimet e lëna nga Rezoluta e Kuvendit synonin mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, duke patur si qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së administratës publike/shtetërore për garantimin e transparencës proaktive, si edhe monitorimin dhe asistencën për instalimin dhe funksionimin e instrumenteve elektronike.

Në lidhje me fushën e përgjegjësisë për mbrojtjen e të dhënave personale, Kuvendi rekomandoi marrjen e masave përfundimtare në përmbylljen e procedurave për miratimin e kuadrit të ri ligjor për këtë fushë, ushtrimin e hetimeve administrative të thelluara për sa i përket zbatimit të detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale për sektorë specifikë si ai i arsimit, shëndetësisë, bankar, etj. Në aspektin e masave tekniko-organizative, specifikisht për

Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) është lënë si detyrë rritja e monitorimit me këtë tematikë në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit, disponueshmërisë dhe besueshmërisë në procesin e përpunimit të të dhënave personale. Rritja e monitorimit/mbikëqyrjes pranë prokurorive për zbatimin e legjislacionit të fushës dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit me Eurojust për mbrojtjen e të dhënave personale është gjithashtu një kriter i lënë për t'u përmbushur. Së fundmi, Kuvendi rekomandon hartimin e një kurrikule profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si një mundësi për zbatim nga sistemi arsimor të këtij materiali.

V.1.2 Roli i institucionit në veprimtarinë e Kuvendit

Në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të datës 27.05.2024 u ngrit Komisioni i Posaçëm “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me qëllim që përmes një procesi publik, gjithëpërfshirës, transparent, profesional të realizojë drejtimin dhe koordinimin e procesit të thelluar të reformave në mirëqeverisje, luftën kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit.

Në respektim të parimit të gjithëpërfshirjes, Komisioni iu drejtua me një ftesë për bashkëpunim:

- *Organizatave të Shoqërisë Civile*
- *Organizatave të Biznesit*
- *Botës Akademike (universiteteve publike e jopublike)*
- *Institucioneve të Pavarura dhe grupeve të ndryshme të interesit*

për t'u përfshirë në mënyrë aktive në këto grupe pune, duke përcaktuar secili prej tyre përfaqësuesit në nivel institucional, si ekspertë të nivelit të lartë, anëtarë të sekretariatit teknik apo si pjesëmarrës dhe kontribues në tryezat dhe forumet publike, të organizuara në kuadër të punës së këtij komisioni.

Zyra e Komisionerit iu përgjigj pozitivisht ftesës së Komisionit duke kontribuar me 2 përfaqësues të saj si ekspertë të nivelit të lartë dhe 2 përfaqësues të tjerë si ekspert pranë sekretariatit teknik të Komisionit. Gjithashtu Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë aktive dhe ka kontribuar në të gjitha tryezat dhe forumet publike të organizuara për këtë qëllim.

Zyra e Komisionerit përfaqësohet me ekspert të nivelit të lartë pranë shtyllave të mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, si dhe me ekspert pranë sekretariatit teknik të shtyllës së mirëqeverisjes.


Ekspertiza e dhënë nga ana e përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit lidhet me të dyja fushat e përgjegjësisë së kësaj zyre, e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, por edhe me kompetencat e tjera të zyrës, konkretisht konsultimin publik dhe të dhënat e hapura.

V.2 PËRPUTHSHMËRIA E AKTEVE RREGULLATORE ME LEGJISLACIONIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Qasja konstante e Zyrës së Komisionerit për harmonizimin e kuadrit rregullator kombëtar me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një praktikë e rëndësishme që ndikon në garantimin e kësaj të drejte themelore nga kontrolluesit (institucione/organe) publikë.

Gjatë vitit 2024, u dhanë mendime për 32 akte rregullative, përfshirë 11 projektligje, 20 projektvendime, 1 draft-metodologji, si dhe 40 opinione për çështje/projekte të paraqitura nga kontrollues publikë apo privatë. Gjatë viteve të fundit shifrat flasin për ndërgjegjësimin në rritje të kontrolluesve publikë lidhur me përputhjen e legjislacionit specifik me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, kur në objekt të tyre këto akte kanë edhe procese përpunuese.

Kjo veprimtari është udhëhequr nga fryma e zbatimit të standardeve të GDPR në legjislacionin shqiptar, ku parimet e përgjegjshmërisë, integritetit, konfidencialitetit apo sigurisë së të dhënave kanë qënë fokus kryesor në këtë drejtim. Gjatë viteve të fundit shifrat flasin për ndërgjegjësimin në rritje të kontrolluesve publikë për përputhjen e legjislacionit specifik me atë të mbrojtjes së të dhënave personale, kur në objekt të tyre këto akte kanë edhe procese përpunuese.



Kjo veprimtari harmonizuese, mban parasysh domosdoshmërinë për arritjen e ekuilibrit midis ndryshimeve/transformimeve shoqërore dhe inovacionit teknologjik në raport me respektimin e kësaj të drejte themelore të individit. Ndër projekt-aktet më kryesore për të cilat është dhënë mendim i konsultoni në lidhjen <https://idp.al/viti-2024-dhenie-mendimi-per-projekt-aktet/>.

VI. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

VI.1 PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një objektiv strategjik kombëtar, ku Zyra e Komisionerit, si pjesë e Kapitullit “Kriteri politik”, Reforma në Administratën Publike, Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, Funksonimi i Institucioneve Demokratike dhe Kapitullit 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, ka dhënë kontributin e saj në të gjitha fazat e procesit të hapjes së negociatave.

VI.1.1 Udhërrëfyesit

Zyra e Komisionerit ka vijuar të ketë një rol tejet aktiv sa i përket përmbushjes së masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” (VKM nr. 736, datë 13.12.2023) si dhe në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike (VKM nr. 737, datë 13.12.2023).

Për përmbushjen e masave dhe rekomandimeve të parashikuara në këto akte, institucioni është angazhuar intensivisht me qëllim realizimin e tyre. Nga ana tjetër, janë ndjekur dhe kryer të gjitha raportimet pranë strukturave përgjegjëse koordinuese për monitorimin e zbatimit të masave të parashikuara në Udhërrëfyes.

VI.1.2 Dokumenti i Anëtarësimit: Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian

Me datë 11 tetor 2024, në Bruksel, u miratua në Konferencën mbi Anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Dokumenti i Anëtarësimit: Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian për Grupkapitullin e Parë - “Themelorët”. Në këtë dokument, përcaktohen piketat e ndërmjetme për këtë grupkapitull, ku ndër të tjera parashikohet se: *“Shqipëria duhet të forcojë më tej mbrojtjen e të drejtave themelore në praktikë. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard të ndërmjetëm pasi të ketë arritur sa vijon: “Miratimin dhe fillimin e zbatimit të reformës për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me acquis-në e BE-së, duke përfshirë reagimin sistematik dhe marrjen e masave mbrojtëse efikase për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale”*”.

Në lidhje me këtë dokument të rëndësishëm, Zyra e Komisionerit ka një kontribut të veçantë pasi përmbushi e para një ndër piketat e ndërmjetme për Grupkapitullin “Themelorët”.

VI.1.3 Progres Raporti i Komisionit Evropian

Bashkimi Evropian vijon të theksojë domosdoshmërinë e përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, forcimin e pavarësisë dhe kompetencave të Komisionerit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për garantimin e respektimit të kësaj të drejte themelore, veçanërisht, nga institucionet publike. Këto rekomandime janë adresuar në mënyrë të përsëritur në Progres Raportet e BE për Shqipërinë, ku për vitin 2024 citohet:

“Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të përshtatet me acquis-në e BE-së. Shqetësimet mbeten për trajtimin e të dhënave personale nga kompanitë private dhe administratat publike si dhe për dobësitë e sistemeve qeveritare të IT. Nevojiten masa

mbrojtëse të forta për të parandaluar shkeljet e të dhënave personale. Duhet të merren veprime të mëtejshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rreziqet e mundshme dhe për të rritur kapacitetin parandalues të institucioneve publike. Kapaciteti i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të forcohet. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale konsultohet sistematikisht për projektligjet që mund të ndikojnë në të dhënat personale; megjithatë, zbatimi i rekomandimeve të tij është i ulët. Ligji duhet të mbrojë plotësisht pavarësinë e Zyrës së Komisionerit dhe ta fuqizojë atë për të miratuar vendime detyruese”.

Rekomandimet e mësipërme, për aq sa janë në kompetencë të institucionit, janë përmbushur me miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, duke e përafuar atë plotësisht me *acquis*, BE.

VI.1.4 Raportime periodike në kuadër të procesit të integritimit

Angazhimi teknik i institucionit në funksion të procesit të integritimit në BE përfshin:

- Pjesëmarrja aktive në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitujt e sipërpërmendur;
- Përgatitja e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të hartimit dhe dërgimit të kontributeve I, II dhe III të qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024;
- Përgatitja e informacionit dhe përfaqësimi në mbledhjen e 15 të Nënkomitetit të BE “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- Përgatitja e kontributit mbi monitorimin e masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe PSIE;
- Ndjekjen e procesit të vlerësimit të SIGMA për Shqipërinë 2024 për Zyrën e Komisionerit dhe kontributit përkatës në sistemin PAR.IS;
- Përgatitja e kontributit në kuadër të hartimit të Raportit të Sundimit të Ligjit të BE 2025;
- Përgatitja e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së Nënkomitetit të Administratës Publike (PAR-Special Group);
- Përgatitja e kontributit për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2025-2027;
- Përgatitja e kontributit për pyetjet shitesë në kapitujt përkatës për raportin e ciklit të dytë të vlerësimit të Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës “Kundër Korrupsionit të Kombeve të Bashkuara” (UNCAC).

VI.2 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE

VI.2.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi në Tiranë, në datat 3-5 qershor 2024, edicionin e XV të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners – ICIC*).



ICIC është forumi më i rëndësishëm i bashkëpunimit midis autoriteteve rregullatore të së drejtës për informim dhe transparencës në mbarë botën. Konferenca e vitit 2024 iu besua për herë të parë Zyrës së Komisionerit, duke pasur parasysh edhe eksperiencën e mëparshme me organizimin e suksesshëm të Asamblesë Botërore të Privatësisë në 2019. Zyra e Komisionerit u mbështet nga Komiteti i Planifikimit, i cili në përbërje të tij kishte anëtarë të Komitetit Ekzekutiv dhe Sekretariatit të ICIC, sa i përket zhvillimit të përmbajtjes së Konferencës.

Organi më i lartë vendimmarrës i Konferencës është Komiteti Ekzekutiv, ku Zyra e Komisionerit është anëtare e zgjedhur që prej 2021. Konferenca përbëhet nga Sesioni i Hapur, me pjesëmarrjen e gjerë të publikut dhe aktorëve të ndryshëm dhe nga Sesioni i Mbyllur me pjesëmarrje vetëm të vendeve anëtare dhe vëzhguese.

Punimet e Konferencës u zhvilluan nën temën “*Fuqizimi i individëve nëpërmjet aksesit në informacion: garantimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes në një botë të ndërlidhur*”.

Punimet e Konferencës u përshëndetën nga i ftuari i nderit z. Edi Rama, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Adrian Alcalá Méndez, President i Bordit të Komisionerëve të INAI, Meksikë dhe njëkohësisht, President i Komitetit Ekzekutiv të ICIC, video përshëndetje nga z. Tawfik Jelassi, Asistent Drejtor i Përgjithshëm për Komunikimin dhe Informacionin në UNESCO, z. Giuseppe Busia, Kryetar i Autoritetit Kombëtar Anti-Korrupsion të Italisë dhe z. Darian Pavli, gjyqtar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg.



Me pjesëmarrjen e mbi 200 përfaqësuesve të shteteve/juridiksiioneve anëtare apo vëzhguese të ICIC nga të gjitha kontinentet, të organizatave ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, UNESCO, Banka Botërore, OECD, nga bota akademike, shoqëria civile apo media, vendas dhe të huaj, përgjatë dy ditëve të sesionit të hapur, u zhvilluan 5 panele kryesore.

Çështjet e trajtuara në to përfshinë diskutime për garantimin e ushtrimit të aksesit në informacion në kontekstin e grupeve vulnerabël, ku u trajtuan mënyrat për të eliminuar pengesat që përballen këto grupe dhe rëndësinë e qasjes për një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Një nga diskutimet e tjera ishte ai mbi ndërveprimin mes autoriteteve rregullatore të fushës me shoqërinë civile dhe median për ta bërë aksesin në informacion dhe transparencën sa më efektive. Ky panel nxori në pah rolin kyç të këtyre aktorëve të cilët me promovimin dhe aktivitetin e tyre nxisin transparencën e autoriteteve publike duke e bërë informacionin publik të arritshëm dhe të përdorshëm për qytetarët – me pjesëmarrjen në panel edhe të Zyrës së Komisionerit.

Në spektrin e teknologjisë dhe të drejtave të tjera, u zhvilluan dy panele paralele lidhur me dinamizmin e mjedisit digjital dhe iniciativave për të dhënat e hapura ku u shqyrtuan mënyrat sesi teknologjitë digjitale mund të përmirësojnë aksesin dhe të fuqizojnë qytetarët përmes aksesit të drejtpërdrejtë në informacionin publik, ndërsa në panelin tjetër u diskutua në lidhje me ekuilibrin që duhet mbajtur mes përparimit të aksesit në informacion dhe respektimin e të drejtave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ky panel u moderua nga Zyra e Komisionerit. Paneli përbëhej nga Komisionerë të cilët mbikëqyrin si të drejtën për informim ashtu dhe atë për mbrojtje të të dhënave personale dhe privatësinë. Diskutimet u përqendruan tek sfidat dhe zgjidhjet për të harmonizuar transparencën me mbrojtjen e privatësisë.

“*Treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm*” të UNESCO mbi aksesin në informacion, ishte një temë me interes sa i përket ecurisë mbi miratimin e legjislacionit të aksesit në informacion në sa më shumë shtete në botë. Ky panel i moderuar nga UNESCO, analizoi progresin dhe sfidat në avancimin e transparencës dhe aksesit në informacion në kontekstin global.



Diskutimet u mbyllën me panelin më të rëndësishëm të konferencës, ai ku anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të ICIC dhe aktorë ndërkombëtarë të shoqërisë civile u mbledhën për të diskutuar arritjet dhe për të vijuar diskursin për vizionin e ardhshëm të konferencës. Panelistët nënvizuan se nevojitet që bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të forcohet edhe më tej. Ndër të tjera u propozua krijimi i mekanizmave bashkëpunuese në luftën kundër keqinformimit. Gjithashtu, u diskutua nevoja për t'u përshtatur me një mjedis në ndryshim të vazhdueshëm, i karakterizuar nga zhvillimet teknologjike, sfida të reja në transparencë dhe shfaqja e kërcënimeve të reja ndaj demokracisë dhe aksesit në informacion.

Gjithashtu, Këshilli i Evropës, Banka Botërore me *Carter Center* dhe Qendra për Ligj dhe Demokraci e Kanadasë, zhvilluan aktivitete paralele me koordinim të Zyrës së Komisionerit. Këshilli i Evropës prezantoi progresin sa i përket vlerësimit të parë të Konventës 205 të Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, si edhe promovoi standardet e saj, si instrumenti i parë detyrues që njeh të drejtën e aksesit në informacion.

Banka Botërore së bashku me *Carter Center* organizuan aktivitetin me temë “*Përgjegjshmëria, Ofrimi i Shërbimeve dhe Përfshirja: Roli i Komisionerëve të Informimit*”. Ky sesion adresoi rolin e Komisionerëve të Informimit me parimet demokratike, duke identifikuar sfidat me të cilat përballen dhe duke shqyrtuar mënyrat se si institucionet shumëpalëshe dhe ndërkombëtare mund të mbështesin angazhime të mëtejshme të tyre.

Ndërsa Qendra për Ligj dhe Demokraci prezantoi një metodologji gjithëpërfshirëse të vlerësimit të zbatimit të ligjeve për të drejtën e informimit.

Në sesionin e mbyllur të konferencës, u prezantuan dhe diskutuan zhvillimet më të fundit rajonale në fushën e aksesit në informacion, duke nxjerrë në pah arritjet dhe sfidat specifike për secilin rajon. Përfaqësuesit nga Afrika raportuan për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe përpjekjet e tyre për të forcuar mekanizmat e aksesit në informacion, përfshirë organizimin e konferencës së ardhshme në Sierra Leone.

Nga Azia, u theksuan përvojat e digjitalizimit për t'ua afuar qytetarëve informacionin publik, megjithëse u identifikuan sfida të tilla si mungesa e kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimi për të drejtën e aksesit. Raporti evropian adresoi çështjet e aksesit në informacion mjedisor dhe përmirësimet legjislativë në Evropën Lindore, duke nënvizuar rëndësinë e interesit publik.

Raportet nga Amerika Latine dhe Karaibet përfshinë deklarata publike mbi çështje zgjedhore dhe mjedisore, si dhe diagnoza për grupe vulnerabël dhe publikimin e të dhënave proaktive. Në Oqeani, një studim mbi qëndrimet ndaj së drejtës për informim sollti të dhëna për përvojat e qytetarëve dhe përdorimin e inteligjencës artificiale për të lehtësuar aksesin në informacion.



Zyra e Komisionerit merr Presidencën e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)

Me propozim të Komitetit Ekzekutiv në mbledhjen e 6-të plenare të tij në dhjetor 2024, Zyra e Komisionerit u propozua që të marrë përkohësisht funksionet dhe rolin e Presidencës së Sekretariatit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC).



Ky është një vlerësim për Zyrën e Komisionerit për profesionalitetin e treguar në organizimin e suksesshëm të Konferencës së ICIC në 2024 në Tiranë, si edhe për kontributin dhe rolin aktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e aksesit në informacion. Ky funksion i përkohshëm do të zgjasë deri në qershor 2025 në konferencën e Berlinit.

VI.2.2 Zyra e Komisionerit zgjidhet anëtare në Grupin e Specialistëve të Konventës 205 të Këshillit të Evropës

Pas ratifikimit të Konventës 205 të Këshillit të Evropës në vitin 2022, nga ana e Shqipërisë dhe miratimin e ligjit nr. 45/2022, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u caktua si organi përfaqësues i Shqipërisë në Këshillin e Palëve. Këshilli i Palëve është një nga dy organet të cilat monitorojnë zbatimin e Konventës. Ai përbëhet nga një përfaqësues nga çdo vend palë dhe ka rolin e organit vendimmarrës, i cili shqyrton opinione apo propozime që paraqiten nga Grupi i Ekspertëve (Access Info Group-AIG). Së fundmi, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale paraqiti kandidaturën për t'u bërë pjesë edhe si anëtare në Grupin e Specialistëve. Në zgjedhjet e zhvilluara në takimin e 4-t të Këshillit të Palëve, përfaqësuesi i Zyrës së Komisionerit u shpall kandidatura fituese mes kandidaturave të tjera. Kjo tregon angazhimin dhe përpjekjet e vazhdueshme për arritjen e standardeve më të larta në fushën e të drejtës për informim në Shqipëri, duke u bërë pjesë e nivelit më të lartë të trupës së ekspertëve në Evropë për aksesin në informacion.

VI.2.3 Këshilli i Evropës vlerëson zbatimin e Konventës 205 nga Shqipëria

Grupi i Ekspertëve (Access Info Group-AIG) të Konventës 205 të Këshillit të Evropës (KiE) “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa e Tromsos) në mbledhjen e muajit nëntor 2024, vlerësoi pozitivisht Shqipërinë në zbatimin e parashikimeve të Konventës. Grupi i Ekspertëve pas analizës së legjislacionit shqiptar paraqiti raportin e vlerësimit paraprak për vendin tonë, i cili përcakton nivelin e përputhshmërisë dhe garancive të parashikuara në ligjin nr. 119/20214 “Për të drejtën e informimit” me ato që parashikon Konventa e Tromsos. Raporti konstaton nivelin bashkëkohor të masave që kuadri rregullator shqiptar përmbush për garantimin e ushtrimit praktik të të drejtës për informim, si një nga liritë dhe të drejtat themelore të qytetarit.

VI.2.4 Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit Shqipëri-Azerbajxhan

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nënshkroi me Komisionerin për të Drejtat e Njeriut (Ombudsman) të Republikës së Azerbajxhanit një Memorandum Mirëkuptimi, për të promovuar respektimin e të drejtës për akses/qasje në informacionin me karakter publik.

Dokumenti u nënshkrua nga titullarët e të dy institucioneve, në një ceremoni të zhvilluar në përfundim të punimeve të Konferencës së 15-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (XV ICIC), në Tiranë. Memorandumi parashikon bashkëpunimin në promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti, atë për të drejtën e informimit, shkëmbimin e informacionit, ekspertizës dhe praktikave më të mira, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe trajnimit të stafeve respektive apo dhe zhvillimin e hetimeve të përbashkëta.

VI.2.5 OECD ftoi Zyrën e Komisionerit për të ndarë eksperiencën në fushën e të drejtës për informim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u ftua nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), për të marrë pjesë në aktivitetin “*Rritja e aksesit në informacion në Jordani: roli i institucioneve publike në zbatimin efektiv të kuadrit të ri rregullator*”. Aktiviteti u organizua nga OECD dhe Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Informimit të Jordanisë, ku morën pjesë mbi 80 autoritete vendase me mbi 100 përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet qendrore, si ministritë e institucione të tjera kyçe në vend. Përfaqësuesi i Zyrës së Komisionerit së bashku me autoritetin spanjoll për të drejtën e informimit u përzgjedhën nga OECD, për të ndarë eksperiencën dhe praktikën më të mira në këtë fushë.

VI.2.6 Takimi i punës së shqyrtimit të rasteve të veçanta “Për të drejtën e informimit”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte pjesëmarrëse në seminarin vjetor për trajnimin e rasteve të veçanta në fushën e të drejtës për informim (Case Handling Workshop – CHW). I organizuar nga Zyra e Këshillit për Transparencë të Spanjës, ky aktivitet dy ditor, mbledhi së bashku 30 përfaqësues nga autoritete homologe evropiane. Në këtë seminar u shkëmbyen eksperiencat dhe praktikat të mira për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit. Ndër të tjera u diskutuan çështje që kanë të bëjnë me balancën në trajtimin e të drejtës për informim në raport me atë për mbrojtjen e të dhënave personale, forcimin e transparencës proaktive dhe metodologjitë në monitorimin efektiv të saj, trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me punësimet në administratën publike, problematika mbi përdorimin e teknologjisë në këtë fushë apo ushtrimin e kësaj të drejte nga gazetarët. Zyra e Komisionerit, në këtë seminar, mbajti një prezantim në lidhje me raste ku transparenca e autoriteteve publike ndërthuret me trajtimin e informacionit/dokumentacionit të rezervuar apo konfidencial.

VI.2.7 Asambleja Globale e Privatësisë (GPA)

Me temën “The power of I” u zhvilluan punimet e edicionit të 46-të të Asamblesë Globale të Privatësisë (Global Privacy Assembly-GPA), duke shënuar ngjarjen kryesore për vitin 2024 në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Ky aktivitet kishte në fokus të punimeve të tij 8 tematika të rëndësishme mbi: individin, inovacionin, informacionin, integritetin, pavarësinë, ndërkombëtarizimin, shkëmbimin ndërkulturor dhe vetëvendosjen/autoktonen. I organizuar nga Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale të ishullit të Xherseit (JOIC), kjo konferencë mbledhi përfaqësues të mbi 160 autoriteteve anëtare e vëzhguese të GPA, nga bota akademike, shoqëria civile, biznesi dhe grupet e interesit, profesioneve të lira, medias, etj.

Gjatë punimeve të sesionit të hapur (28-30 tetor) u diskutuan dhe trajtuan çështje të ndjeshme në lidhje me respektimin dhe balancimin e fuqisë së informacionit që qytetarët duhet të kenë me qëllim kontrollin e të dhënave të tyre personale. Tematikat e prekura kishin të bënin me përcaktimin e dëmeve të privatësisë në botën moderne, mbrojtjen e të dhënave dhe shëndetin mendor, ndikimin e teknologjisë mbi autoritetet rregullatore apo dhe përparësitë dhe sfidat e mjeteve të transferimit të të dhënave. Njëkohësisht të pranishmit diskutuan edhe mbi rolin e privatësisë së të dhënave në krizat humanitare, reduktimin e pabarazive në të drejtat e

privatësisë-eksplorimin e dimensioneve të ndryshme të privatësisë së diversitetit, ndarjen e të dhënave ndërmjet qeverisë dhe palëve të treta, etj. Konferenca promovon rritjen e aftësive të individëve në vetëmenaxhimin e të dhënave personale, si dhe forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë dhe transparencës gjatë përdorimit këtyre të dhënave.

Gjatë punimeve të sesionit të mbyllur u miratuan këto dokumente:

- Rezoluta për inkurajimin dhe përdorimin e mekanizmave të certifikimit në mbrojtjen e të dhënave;
- Rezoluta për teknologjitë e mbikëqyrjes nga organet ligjzbatuese dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve për privatësi;
- Rezoluta për shkëmbimin e lirë dhe me besim të të dhënave dhe për rregullimin efektiv të flukseve globale të të dhënave;
- Rezoluta mbi parimet e përpunimit të informacionit personal në neuroshkencë dhe neuroteknologji;
- Rezoluta mbi Rregullat dhe Procedurat e GPA.

GPA mbetet forumi kryesor ndërkombëtar dhe më me ndikim në procesin e vendimmarrjes mbi politikat publike në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

VI.2.8 Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit mori pjesë në edicionin e 32-të të Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, njohur ndryshe si Spring Conference.

Ky është aktiviteti kryesor vjetor që mbledh së bashku autoritetet/institucionet homologe të kësaj fushe në kontinentin tonë, për të diskutuar dhe ndarë eksperiencat më të mira për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve. Konferenca i zhvilloi punimet përgjatë 3 ditëve dhe ishte e organizuar në 6 panele kryesore. Tematika të përzgjedhura nga organizatorët kishin të bënin me përdorimin e teknologjve në përpunimin e të dhënave personale dhe domosdoshmërinë për të përmirësuar në vazhdimësi bazën rregullatore, mbrojtjen e të dhënave shëndetësore në epokën digjitale, forcimin e bashkëpunimit mes autoriteteve homologe, si dhe mbi ndërveprimin e kuadrit ligjor evropian (GDPR) me veprimtarinë në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave.

Në panelin kushtuar “Rolit të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave në përmirësimin e kuadrit rregullator në epokën digjitale” Zyra e Komisionerit, u prezantua me temën “Siguria e të dhënave personale në Shqipëri dhe sfidat e digjitalizimit”.

VI.2.9 Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB)

Zyra e Komisionerit është anëtare me statusin e vëzhguesit në këtë forum që nga viti 2016. Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave është organizmi më i lartë i BE-së që miraton aktet për mbikëqyrjen e zbatimit të unifikuar të Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky forum përbëhet nga titullarët e autoriteteve kombëtare të mbrojtjes së të dhënave të vendeve anëtare të BE-së të cilët mblidhen periodikisht, fizikisht ose në formatin online.

VI.2.10 Samiti Vjetor i Privatësisë, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë IAPP

Në kuadër të “Ditës së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave”, zhvilluar si pjesë e agjendës së Samitit Vjetor të Privatësisë, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë (International Association of Privacy Professionals – IAPP), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mori pjesë në takimin që u mbajt në Shtëpinë e Bardhë, drejtuar nga z. Rohit Chopra – Drejtor i Byrosë së Mbrojtjes Financiare të Konsumatorëve. Diskutimet u fokusuan në çështje të rëndësishme, duke marrë në konsideratë përparimin teknologjik, flukset e të dhënave personale në një ekonomi të ndërlidhur globalisht dhe sfidat për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.



Po ashtu, u zhvillua edhe një pritje në Komisionin Federal të Tregtisë nga kreu i tij, znj. Lina Khan, ku zyrtarët e lartë patën rastin të diskutonin për intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe përmirësimin e kuadrit rregullator për standardet më bashkëkohore në mbrojtjen e të dhënave personale.

VI.2.11 Bordi Mbikëqyës për Mbrojtjen e të Dhënave të EUROCONTROL

Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigimit Ajror, EUROCONTROL, ka përditësuar kuadrin e saj për mbrojtjen e të dhënave personale për t'u përshtatur me standardet bashkëkohore. Një komponent kyç është krijimi i Bordit Mbikëqyrës për Mbrojtjen e të Dhënave (DPSB), autoritet i pavarur përgjegjës për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së EUROCONTROL me rregulloret e saj për mbrojtjen e të dhënave dhe për trajtimin e ankesave nga individë, punonjës apo palë të jashtme, të cilëve u përpunohen të dhënat personale nga organizata. Ky bord shqyrton dhe këshillon mbi politikën e mbrojtjes së të dhënave, monitoron aktivitetet e përpunimit të të dhënave dhe jep udhëzime për të siguruar mbrojtjen e drejtave të privatësisë së individëve në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, duke përfshirë Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR).

Në cilësinë e Anëtarit të Bordit Mbikëqyrës për Mbrojtjen e të Dhënave të EUROCONTROL (Data Protection Supervisory Board, DPSB), Zyra e Komisionerit mori pjesë në Mbledhjen e parë të tij.

VI.2.12 Pjesëmarrje në forume të tjera

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare Zyra e Komisionerit, ka marrë pjesë në forume, aktivitete, mbledhje takime, trajnime apo seminare të organizuara nga:

- Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD);
- Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji (Grupi i Berlinit);
- Mbledhja e Autoriteteve të Evropës Qendore dhe Lindore të Mbrojtjes së të Dhënave;
- Akademia e Mbrojtjes së të Dhënave;
- Seminari “Digital Horizons: Safeguarding Data in the Age of Innovation”;
- Forumi Internet Freedom;
- Mbrojtja e të dhënave në Ballkanin Perëndimor dhe Rajoni i Partneritetit Lindor, RCC.

VII. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE

VII.1 AKTIVITETET NDËRGJEGJËSUESE DHE DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE

DITA NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE – 28 Janar 2024

Zyra e Komisionerit, me rastin e 28 Janarit, bashkëpunoi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe strukturat e saj të varësisë për zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere në disa shkolla të mesme të përgjithshme në vend. Ato u mbajtën në mjediset e gjimnazeve “Ismail Qemali” në Tiranë, “Hydajet Lezha” në Lezhë, “Dhaskal Todri” në Elbasan dhe “Naim Frashëri” në Durrës.

Me pjesëmarrjen e nxënësve, mësuesve dhe prindërve, këto takime kishin në fokus zgjerimin e njohurive mbi përdorimin e sigurt të mjedisit digjital dhe teknologjisë, për mbrojtje efektive të privatësisë dhe të dhënave personale. Të zhvilluara në formën e bashkëbisedimit të lirë, në to u prezantua roli dhe funksionet e Zyrës së Komisionerit, u diskutua mbi të drejtat dhe mënyrat e ushtrimit të tyre, si dhe u ndanë këshilla praktike lidhur me sjelljen e të rinjve në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale. Një proces i ligjshëm, i përgjegjshëm, transparent dhe me standarde të larta sigurie në përpunimit e të dhënave personale, ndikon edhe në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Në këtë mënyrë, këto aktivitete i shërbejnë objektivit të rëndësishëm për edukimin sa më të mirë të brezit të ri, por edhe nxitjes për përgatitjen e profesionistëve të aftë në këtë fushë. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit në kuadër të krenimit të kësaj Dite, nëpërmjet bashkëpunimit me (DPO) në institucione publike/shtetërore dhe kompani të ndryshme private, është shpërndarë një video ndërgjegjësuere, për të treguar kujdes maksimal në përdorimin e pajisjeve elektronike dhe teknologjisë, në kuadër të ruajtjes së informacionit dhe të dhënave personale të qytetarëve.

KONFERENCA E VI KOMBËTARE “NDËRTIMI I BESIMIT: PROMOVIMI I TRANSPARENCËS, LLOGARIDHËNIES DHE INTEGRITETIT NË POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT”

Zyra e Komisionerit dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Anti-korrupsionin (MAPA), në datën 26 qershor 2024, bashkëorganizuan Konferencën e VI Kombëtare për të Drejtën e Informimit me temë “Ndërtimi i besimit: promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”. Fokusi i këtij aktiviteti ishte roli i shoqërisë civile dhe medias në promovimin e së drejtës për akses në informacionin publik dhe forcimin e transparencës, për ngritjen e institucioneve përgjegjëse si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, për forcimin e llogaridhënies, etj. Konferenca e VI Kombëtare mbledhi së bashku zyrtarë dhe përfaqësues të nivelit të lartë, si dhe koordinatorë nga mbi 150 autoritete publike qendrore, të pavarura, sistemi i drejtësisë dhe vetëqeverisja vendore, së bashku me ekspertë të shoqërisë civile, aktivistë dhe media. Gjatë këtij aktiviteti u nënvizua qasja ndaj konsolidimit të institucioneve të qëndrueshme dhe demokratike, përmes garantimit të së drejtës për akses në informacion, rritjes së transparencës dhe rritjes së llogaridhënies, si çelësi i pjesëmarrjes së qytetarëve në mirëqeverisje. Në Konferencën e VI Kombëtare u prezantua gjendja e transparencës së autoriteteve publike shqiptare, sfidat aktuale, si dhe propozimet për përmirësimin e mëtejshëm. Në sesionin e hapjes së Konferencës u theksua se transparenca nuk është vetëm një objektiv strategjik në vetvete, por është edhe paradhoma e luftës kundër

korruptionit. Gjatë dy paneleve speciale "Zbatueshmëria e ligjit për të drejtën e informimit parë nga perspektiva e autoriteteve publike, e ardhmja e transparencës proaktive" dhe "Transparenca e autoriteteve publike parë nga këndvështrimi i shoqërisë civile dhe medias", panelistët theksuan se rritja e besimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjitha palëve/aktorëve të këtij procesi dinamik, është e rëndësishme për të arritur objektivin e përbashkët: garantimin e ushtrimit të kësaj të drejte dhe lirie themelore nga qytetarët me standardet më të larta.

DITA E SË DREJTËS PËR INFORMIM - 28 SHTATOR 2024

Me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit zhvilloi në mjediset e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil një aktivitet informues e ndërgjegjësues. Legjislacioni për të drejtën e informimit ashtu si edhe ai për shërbimin civil kanë për qëllim të ndikojnë në formësimin e një administrate publike të përgjegjshme dhe profesionale, për të ofruar shërbime cilësore, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i eksperiencave mes nëpunësve, njohja me praktikatat më të mira respektive dhe ngjashmëritë apo pikat e përbashkëta të kuadrit rregullator në ushtrimin e përgjegjësisë sipas fushave të veprimtarisë. Një nga çështjet kryesore të diskutuara në këtë takim ishte publikimi i informacionit/dokumentacionit që ka të bëjë me vendimmarrjen e autoriteteve publike në kuadër të transparencës proaktive, ashtu si edhe konsolidimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit brenda strukturave institucionale. Vëmendje iu kushtua zbatimit me korrektësi të legjislacionit për shërbimin civil, në trajtimin me balancë dhe proporcionalitet të të drejtës për informim dhe asaj për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky bashkëpunim dhe ndërveprim mes stafeve të institucioneve të pavarura siguron një njohje më të zgjeruar të kornizës ligjore dhe procedurave të njëri-tjetrit, për të nxitur përgjegjshmërinë dhe integritetin në ushtrimin e kompetencave institucionale.

Edukimi i brezit të ri për njohjen dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore është i rëndësishëm për një shoqëri demokratike dhe të zhvilluar. Në kuadër të aktiviteteve me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit zhvilloi takime me nxënës e mësues të arsimit 9-vjeçar publik e privat, me moton "Mos ki ndrojtje të pyesësh". Takimet kishin si qëllim prezantimin e koncepteve dhe parimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit për këtë grup-moshë dhe rritjen e ndërgjegjësimin në ushtrimin praktik të kësaj të drejte.

- Gjatë muajve mars, korrik dhe dhjetor, u zhvilluan 5 trajnime me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për të dhënat e hapura nga të gjitha autoritetet publike/organet e sektorit publik qendrore dhe të strukturave të varësisë, të organeve të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të pavarura, atyre të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori) të shoqërive/kompanive me kapital publik, etj. Trajnimet u fokusuan në tre elemente kryesore:
 - Përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me aksesin në informacionin publik dhe publikimin/përditësimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
 - Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve nëpërmjet portalit pyetshtetin.al, instalimi/përditësimi i tij në autoritete publike të reja apo ku ka patur ndryshim të koordinatorit;

- Përbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik.

Stafi i Zyrës së Komisionerit bashkëveproi me të pranishmit për të adresuar problematika nga më të ndryshmet në lidhje me përditësimin e vazhdueshëm të tyre, duke ofruar shembuj sipas praktikave më të mira vendase dhe të huaja.

- Me tematikën “*Ndërtimi i besimit, rruga e Shqipërisë në BE drejt qeverisjes transparente*” u zhvillua forumi i bashkëorganizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) dhe Delegacioni i BE në Shqipëri, në mbyllje të “Javës së Integritetit”, ku pjesë e rëndësishme e forumit ishte dhe pjesëmarrja e Zyrës së Komisionerit. Në këtë aktivitet Zyra e Komisionerit ndau me të pranishmit eksperiencën 10-vjecare në zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit në Shqipëri, arritjet dhe sfidat me të cilat përballet kjo e drejtë.
- Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në Ministrinë e Financave zhvilluan një modul trajnimi 2-ditor. Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 70 nëpunës të niveleve dhe strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore të këtyre institucioneve, të cilët u njohën me përbushjen e detyrimeve të legjislacionit në fuqi për fushat e përgjegjësisë të Zyrës së Komisionerit, rolin e funksionet e institucionit, si dhe zbatimin e këtij kuadri rregullator në raport me veprimtarinë e administratës tatimore dhe asaj doganore.
- Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mikpriti një grup përfaqësuesish të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të “*Programit të shkëmbimit të OJF*”. Në fokus të këtij takimi ishte njohja me rolin dhe funksionet e institucionit dhe bashkëveprimi për nxitjen e pjesëmarrjes sa më aktive të qytetarëve dhe palëve të interesuara në vendimmarrjen e autoriteteve publike. Pjesëmarrësit në këtë takim ishin nga shoqata/organizata të reja që e kanë selinë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Berat, Korçë, Elbasan apo dhe Tiranë. “Programi i Shkëmbimit të OJF” është nismë e Partnerët Shqipëri (Partners Albania), e cila ka për qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e sektorit të organizatave të shoqërisë civile, kryesisht atyre lokale.
- Shkolla “*Transparenca dhe Qeverisja e Hapur 2024*” është një program i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, që ka në fokus jo vetëm njohjen me kuadrin ligjor kombëtar por edhe zbatimin e tij në praktikë nga profesionistët e së ardhmes. Në prezantimin e tij, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerësoi se procesi i transparencës së autoriteteve publike rrit përgjegjshmërinë e tyre, nxit llogaridhënien e vazhdueshme dhe mundëson pjesëmarrjen efektive të qytetarëve në qeverisje. Në këtë këndvështrim, ai theksoi se edhe digjitalizimi i shërbimeve publike është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për ta forcuar akoma edhe më shumë në praktikë konceptin e transparencës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, një grup studentësh pjesëmarrës në këtë Shkollë, ishin të pranishëm gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore me autoritete publike. Njëkohësisht, ata u njohën edhe me kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, procesin e modernizimit të tij dhe me trajtimin e rasteve konkrete.

- Në mjediset e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua takimi me një grup studentësh të programit Gazetari-Komunikim të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në këtë aktivitet, të zhvilluar në formën e një bashkëbisedimi të lirë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale prezantoi një panoramë të legjislacionit të të drejtës për informim, i njohu me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe mbi trajtimin e rasteve nga praktika. Një aspekt i rëndësishëm në këtë drejtim është forcimi i transparencës së autoriteteve publike, duke ndikuar në nxitjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së tyre përballë qytetarëve. Njëkohësisht, studentët shfaqën interes edhe për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si një e drejtë tjetër themelore individuale, mbi raportet e saj me teknologjinë dhe digjitalizimin e shërbimeve. Aktiviteti u zhvillua si pjesë e takimeve në institucione shqiptare në kuadër të projektit “*Media 2040: avokimi i të rinjve për lirinë e medias në Ballkanin Perëndimor*”, i cili realizohet nga gjashtë universitete të rajonit: Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universiteti i Novi Sadit, Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Sarajevës dhe Universiteti i Shkupit “Shën Kirili dhe Metodi”.
- Në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një vizitë studimore me aktivistë të programit “Shkëndijat”, i zbatuar nga Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Co-PLAN. Në fokus të tij ishte njohja me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit në dy fushat e përgjegjësisë, në drejtim të garantimit të ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore nga qytetarët. Programi “Shkëndijat” zbatohet prej disa vitesh duke mbështetur aktivistë, profesionistë dhe organizata jofitimprurëse nga i gjithë vendi, që çojnë përpara nisma me rëndësi për komunitete të ndryshme lokale.
- Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në edicionin e 30-të të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës (PNT30), në datat 6-9 nëntor 2024. Ky aktivitet shërbeu si një platformë informimi dhe ndërveprimi mes komuniteteve të biznesit dhe jo vetëm, për të krijuar ura bashkëpunimi mes tyre dhe institucioneve publike.
- Në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës në Shqipëri të Organizatë për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 3 aktivitete, (*Tiranë, Shkodër, Korçë*) aktivitete lidhur me prezantimin e gjetjeve të Rekomandimit Unifikues “*Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale për kontrolluesit e arsimit të mesëm të lartë*”. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të Bashkisë, si dhe nga të gjitha strukturat vendore arsimore (ZVA) në varësi të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, mësues, psikologë, prindër dhe nxënës. Zhvillimi i të tilla takimeve kanë ndikim në nxitjen e ndërveprimit në funksion të misionit për edukimin sa më cilësor të brezit të ri. Në këtë rekomandim janë evidentuar problematika që kanë të bëjnë me zbatimin korrekt të legjislacionit të fushës, sidomos, për rritjen e masave të sigurisë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale, veçanërisht gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe platformave teknologjike. Një kujdes i posaçëm, duhet t’i kushtohet të dhënave personale të fëmijëve/nxënësve nën 18 vjeç (të mitur), për të shmangur pasojat e rënda që mund të vijnë për shkak të publikimit online të të dhënave të

tyre. Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit prezantoi edhe parimet e modulit trajnues “*Mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë gjatë lundrimit në internet*”, të hartuar nga institucioni. Ky dokument u shërben strukturave arsimore për përdorimin e duhur të rrjeteve sociale, kujdesin për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, si dhe rëndësinë e sigurisë online nga rreziqet që ndeshen në mjedisin digjital.

- Zyra e Komisionerit ka realizuar me iniciativën e saj hetime administrative në institucione shëndetësore publike të kujdesit parësor (qendra shëndetësore dhe ato të specialiteteve), për të monitoruar procedurat e përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve në sektorin shëndetësor. Për të rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale, në mjediset e gjimnazit “*Sami Frashëri*”, u zhvillua me një grup nxënësish dhe mësuesish një sesion trajnues mbi legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale, parimet dhe kriteret mbi të cilat zhvillohet ky proces, raportet që krijohen në këtë fushë me zhvillimin e teknologjisë dhe digjitalizimin e shërbimeve, si dhe njohjen me raste konkrete.
- Zyra e Komisionerit publikon që prej vitit 2020 një Newsletter “*Për të drejtën e informimit*” përmbledhje mujore mbi veprimtarinë, mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Newsletter publikohet çdo muaj në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit si dhe shpërndahet pranë koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Edhe gjatë këtij viti u publikuan 12 numra të Newsletters “*E drejta për informim*”.

VII.2 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Zyra e Komisionerit vijon t’i kushtojë rëndësi të veçantë ndërveprimit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe median, si partnerë në funksion të interesit publik, për kultivimin e kulturës së ndërgjegjësimit të qytetarëve për ushtrimin e të drejtës për informim dhe pjesëmarrjes në qeverisje. Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka kontribuar dhe bashkëpunuar me grupet e interesit në zhvillimin dhe pjesëmarrjen aktive për projekte dhe iniciativa të ndryshme, ndër të cilat mund të veçojmë:

- Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte e ftuar në prezantimin e “Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë (SKSH) 2021-2030, arritjet dhe sfidat” i hartuar nga shoqata “Together for Life” (TFL). Ky dokument është një platformë e rëndësishme për zhvillimin dhe përmirësimin e këtij sistemi në vendin tonë që synon të sigurojë një kujdes shëndetësor cilësor, të aksesueshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Në këtë takim, Zyra e Komisionerit mori vlerësime nga TFL për kontributin dhe mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit të mbledhjes së informacionit të domosdoshëm për hartimin e këtij raporti. Përfaqësuesit e institucionit theksuan se roli që ai luan në garantimin e së drejtës për informim do të ishte jo i plotë pa bashkëpunimin dhe ndërveprimin me organizatat e shoqërisë civile, për arritjen e objektivit të përbashkët, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.
- Zyra e Komisionerit mori pjesë në prezantimin e raportit të monitorimit 6-mujor të zbatimit të buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës janar-qershor 2024, hartuar në kuadër të projektit “Qytetarët të parët: Bashkia për një qeverisje vendore transparente”, zbatuar nga shoqata

“Together for Life” (TFL), në bashkëpunim me IDM, Faktoje.al dhe Qendrën për Kërkim dhe Politikbërje, mbështetur nga Delegacioni i BE-së në Tiranë.

- Zyra e Komisionerit adresoi Konferencën Kombëtare për Prezantimin e Raportit Krahasimor mbi zbatimin e ligjit të konsultimit publik nga pushteti vendor në 10 bashki të Shqipërisë. Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit “Rrjeti POP për Qeverisje të Mirë dhe Integritet,” mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare “Olof Palme” dhe Qeveria Suedeze.
- Zyra e Komisionerit mori pjesë në tryezën e rrumbullakët “Transparenca dhe Aksesueshmëria në Sistemin Shëndetësor dhe Arsime” organizuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN Albania). Ky aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “Mbështetje për Pjesëmarrjen, Përgjegjshmërinë dhe Fuqizimin e Shoqërisë Civile” (SPACE) zbatuar nga Organizata Together for Life (TFL) në partneritet me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe Destiny Center for Excellence, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
- Zyra e Komisionerit mori pjesë në tryezën e rrumbullakët “Mbrojtja e të dhënave personale nga partitë politike”, të organizuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci në Shqipëri (WFD). Kjo tryezë në zbatim të projektit si dhe në kuadër të zgjedhjeve parlamentare 2025, kishte në fokus mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve dhe zbatimin e kuartrit ligjor nga partitë politike në aktivitetet e tyre elektorale.
- Workshop në qytetin e Ohrit (Maqedonia e Veriut), me një panel ekspertësh në fushën e të drejtave të njeriut dhe teknologjisë së informacionit ku katër organizata të shoqërisë civile në rajon, përkatësisht Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, Komiteti i Helsinkit të Maqedonisë së Veriut dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, po zbatojnë iniciativën “Digjitalizimi i Administratës Publike dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale: afrimi drejt Integritimit Evropian me vëmendje”. Qëllimi kryesor i kësaj nisme synon hartimin e një rezolute me gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e situatës në rajon, dokument i cili do të diskutohet më vonë në Kuvendet e të gjitha vendeve zbatuese.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, ishte i ftuar në aktivitetin përmbyllës të projektit “Festivali Kombëtar i të Drejtave Digjitale”. I organizuar në formën e një bashkëbisedimi të lirë, ky takim mbledhi së bashku të rinj, ekspertë të fushës, përfaqësues nga institucione publike dhe nga organizata të shoqërisë civile, të cilët diskutuan në lidhje me avancimin e të drejtave digjitale dhe ndërtimin e një mjedisi të qëndrueshëm kibernetik.

VIII. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

VIII.1 AKTE RREGULLATORE

VIII.1.1 Miratimi i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Seancën Plenare, të datës 19.12.2024 miratoi ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Ky akt i rëndësishëm rregullator përbën një hap përpara për implementimin e standardeve më bashkëkohore të mbrojtjes së kësaj të drejte themelore për qytetarët shqiptarë. Legjislacioni i modernizuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është gjithashtu përmbushje e një prej detyrimeve, në kuadër të procesit të integritit të vendit në Bashkimin Evropian (BE), pasi ky akt përafuron plotësisht Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën për përpunimin e të dhënave personale nga organet ligjzbatuese (Direktiva e Policisë).

Ligji i ri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, u miratua pas një periudhe të gjatë diskutimesh dhe konsultimesh me grupet e interesit, si edhe me asistencën e vyer të ekspertëve të Bashkimit Evropian.

Ky ligj i ri u garanton qytetarëve një nivel më të lartë kontrolli mbi të dhënat e tyre personale, duke sjellë një sërë risish në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, pasi:

- Zgjerohet kategoria e të drejtave të individit;
- Përmirësohen të drejtat që subjekti gëzon aktualisht me qëllim garantimin e një niveli kontrolli më të lartë mbi të dhënat e tij personale;
- Forcohet e drejta për akses;
- Rregullohet posaçërisht e drejta për të mos i'u nënshtruar vendimeve automatike; si edhe
- Rregullohet “e drejta për t’u harruar”, duke detyruar motorët e kërkimit të fshijnë me kërkesë të subjektit të të dhënave, informacionin në lidhje me të, i cili me kalimin e kohës nuk është më i nevojshëm.

Ndërsa për kontrolluesit dhe përpunuesit, lindin detyrime të reja, me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale. Nëse në ligjin e shfuqizuar detyrimet e kontrolluesit përcaktoheshin në një nen të vetëm, në këtë ligj këtij elementi i kushtohet një kapitull i tërë, ku trajtohen gjerësisht detyrimet dhe masat që një kontrollues duhet të ndërmarrë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me detyrimet e ligjit dhe sigurinë e të dhënave. Ligji mundëson rritjen e “përgjegjshmërisë” dhe “llogaridhënies” në procesin dinamik të përpunimit të të dhënave personale duke garantuar mbrojtjen më efektive të tyre dhe aplikim të sanksioneve më të forta në rast shkeljeje të dispozitave të tij.

Përafrimi i kuadrit rregullator kombëtar me atë të BE-së konsolidon dhe forcon rolin e Zyrës së Komisionerit për t’iu përgjigjur më mirë sfidave e problematikave të cënimit të privatësisë dhe për mbrojtjen e duhur të të dhënave personale. Avancimi në rrugën e integritit evropian, ashtu si edhe konsolidimi i mekanizmave të një shoqërie demokratike me ekonomi të zhvilluar, kërkon një kuadër ligjor bashkëkohor dhe të konsoliduar, i cili ka në themel respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.



Procesi i njohjes, kuptimit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale do të jetë sfidues, por edhe një proces në vazhdimësi dhe për këtë Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar për të lehtësuar dhe mbështetur sa më shumë qytetarët, kontrolluesit e përpunuesit e të dhënave në zbatimin e detyrimeve të ligjit.

VIII.1.2 Udhëzimi nr. 463/2020

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, ka përditësuar Ankesin I të Udhëzimit nr. 463/2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, i ndryshuar, duke shtuar institucionet të cilat kanë depozituar kërkesën për t’u bërë pjesë e tij.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka luajtur rol aktiv, për sa i përket projektakteve që i dërgohen për vlerësim, në ndërgjegjësimin e institucioneve për t’u përfshirë tek Aneksi I, në rastet kur parashikojnë përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, nga Regjistri i Gjendjes Civile.

VIII.2 DOKUMENTE STRATEGJIKE

VIII.2.1 Strategjia Institucionale 2022-2025

Në kuadër të Strategjisë Institucionale 2022-2025 dhe Planit të saj të Veprimit, u hartua Raporti i Monitorimit mbi zbatimin e objektivave të parashikuar për periudhën 2024. Nga 31 masa specifike të parashikuara në Planin e Veprimit të strategjisë:

Dy masa zbatohen në vazhdimësi, nga ana e Zyrës së Komisionerit, si:

- *nxitja e kontrolluesve publik e privat për t’u drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë;*
- *forcimi i kapaciteteve administrative në shqyrtimin e praktikave në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.*

Dy masa janë në proces për t’u realizuar në vitin 2025, konkretisht:

- *miratimi i projektligjit “Për krijimin e Regjistrit të Komunikimeve Tregtare të pa kërkuara”;*
- *promovimi i qasjes së re të kontrolluesëve dhe përpunuesëve në procesin e përpunimit të të dhënave personale me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit.*

Ndërkohë, për vitin 2024, është realizuar masa “*Miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafëruar me acquis të BE në këtë fushë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij*”, duke rezultuar në 27 masa të përgjithshme të përmbushura nga objektivat e Strategjisë Institucionale 2022-2025.

VIII.2.2 Plani i Integritetit 2022-2025

Zyra e Komisionerit, gjatë vitit 2024, është përzgjedhur si institucion pjesëmarrës në fazën pilot për hartimin e metodologjisë së vlerësimit të indeksit të integritetit të institucioneve publike, në bashkëpunim me ekspertë të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Pas miratimit të këtij dokumenti, Zyra e Komisionerit i është nënshtruar vlerësimit përkatës nga ana e ekspertëve të IDM me qëllim vlerësimin e kuadrit institucional për promovimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, kapacitetet e Zyrës së Komisionerit për përmbushjen e objektivave të integritetit të vendosura nëpërmjet planeve të integritetit, transparenca dhe llogaridhënia ndaj përfituesve të shërbimeve, si dhe nëse institucioni e realizon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të këtij procesi, ekspertët hartuan raportin “*Vlerësimi i Indeksi të Integritetit për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i cili synon të pasqyrojë ndikimin e masave të ndërmarra nga institucioni në forcimin e integritetit institucional. Referuar këtij raporti, Zyra e Komisionerit vlerësohet në tërësi si një institucion me një nivel të lartë të përgjegjshmërisë institucionale për sa i përket transparencës proaktive, llogaridhënies, qasjes strategjike ndaj standardeve të integritetit dhe sjelljes së mirë, si dhe meritokracisë në përmbushjen e detyrave, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Raporti i monitorimit të indeksit të integritetit institucional të Zyrës së Komisionerit u hartua duke vlerësuar zbatimin e Planit të Integritetit 2022-2025, masat e marra për forcimin e integritetit institucional, nivelin e zbatimit të Programit të Transparencës, si dhe ndërveprimin e tij me aktorë të tjerë, përfshirë edhe publikun në tërësi.

VIII.2.3 Strategji Ndërsektoriale

Zyra e Komisionerit është institucion i përfshirë në disa strategji kryesore ndërsektoriale në vend nëpërmjet objektivave që lidhen me fushën e veprimtarisë e për të cilat është përgjegjëse/mbështetëse në zbatimin e tyre.

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030

Institucioni është përgjegjës dhe ka raportuar zbatimin e sfidës *“Mbrojtja e të dhënave të qytetarëve sipas standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave dhe forcimi/promovimi i transparencës proaktive me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike”*, në kapitullin *“Forcimi i të drejtave të njeriut”*.

- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Indikatorëve

Institucioni është përgjegjës dhe ka raportuar për zbatimin e masës 1.1.10: *“Fushata ndërgjegjësuere kombëtare për promovimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin”*, për sa i përket përmbushjes së aktivitetit 1.1.10.1: *“Fushatë kombëtare ndërgjegjësuere me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrativ)”*.

- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 dhe Plani i Veprimit

Institucioni është përgjegjës dhe ka raportuar për përmbushjen e masës 3.3.1 *“Sigurimi i të drejtës së viktimës për mbrojtje dhe njohja e viktimave me nevoja specifike mbrojtje gjatë procedimeve penale”*, mbi realizimin e aktivitetit 3.3.1.2 *“Organizimi i trajnimeve, ërkshopeve me qëllim rritjen e aftësive të profesionistëve mbi zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit të të dhënave personale dhe mbi detyrimet e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale për viktimat e krimit”*.

- Agjenda Kombëtare e të Drejtave të Fëmijëve 2021–2026

Institucioni është përgjegjës dhe përmbushi gjatë veprimtarisë së tij objektivin specifik IV.1: *“Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale”*.

Njëkohësisht Zyra e Komisionerit ka dhënë kontribut aktiv në përgatitjen e objektivave/masave/aktiviteteve konkrete gjatë procesit të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030, Strategjisë Kombëtare e Migracionit 2024-2030, Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 si dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike.

VIII.3 PROCESE GJYQËSORE

VIII.3.1 Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”

Zyra e Komisionerit ka qenë palë në 36 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështje me objekt legjislacionin për të drejtën e informimit.

| <i>Specifikat e Çështjes</i> | <i>Transparenca Proaktive</i> | <i>Aksesi në informacion</i> |
|---|-------------------------------|------------------------------|
| <i>Procese gjyqësore</i> | 3 | 33 |
| <i>Rrëzim padie</i> | 0 | 13 |
| <i>Pranim padie</i> | 2 | 2 |
| <i>Pranim i pjesshëm i padisë</i> | 0 | 4 |
| <i>Pushim gjykimi për Zyrën e Komisionerit</i> | 0 | 0 |
| <i>Çështje e kthyer për mangësi në kërkesë padi</i> | 0 | 4 |
| <i>Çështje të pezulluara</i> | 0 | 1 |
| <i>Çështje në proces</i> | 1 | 9 |

Bazuar në të dhënat statistikore të raportuara në tabelën e mësipërme, rezulton se vendimmarrja e Komisionerit është lënë në fuqi nga gjykata në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit. Nga 21 procese gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2024, Gjykata e Shkallës së Parë ka pranuar 4 padi dhe pjesërisht 4 padi të tjera, kundrejt 13 kërkesë padive të rrëzuara.

Vlen të theksohet se 2 nga kërkesë paditë e pranuar në lidhje me vendimmarrjen e Komisionerit mbi çështjet e transparencës proaktive, konsistojnë në shfuqizimin e masës administrative gjobë por themeli i detyrimit për vënien në zbatim të programit të transparencës, ka mbetur në fuqi.

VIII.3.2 Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar

Institucioni ka qenë palë në 22 procese gjyqësore pranë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështje me objekt legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

| <i>Specifikat e Çështjes</i> | <i>Numri i rasteve</i> |
|-----------------------------------|------------------------|
| <i>Procese gjyqësore</i> | 22 |
| <i>Pranim padie</i> | 0 |
| <i>Rrëzim padie</i> | 12 |
| <i>Pranim i pjesshëm i padisë</i> | 1 |
| <i>Çështje në proces</i> | 9 |

Gjatë vitit 2024 Zyra e Komisionerit ka qenë palë në 22 procese gjyqësore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me objekt zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në 12 prej këtyre çështjeve, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit. Për një të tretën prej tyre, gjykata ka vendosur pranim të pjesshëm të padisë. Vlen të theksohet se, në asnjë prej këtyre çështjeve gjyqësore, nuk është shfuqizuar vendimi i Komisionerit.

Gjithashtu, deri në dhjetor 2024, janë 9 çështje të cilat mbeten ende në proces shqyrtimi nga ana e gjykatës.

Zyra e Komisionerit është palë në 95 procese gjyqësore për çështje ndër vite në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Gjatë vitit 2024, kjo gjykatë është shprehur me vendim vetëm për 6 çështje. Kjo situatë ka krijuar vonesa në konsolidimin e jurisprudencës në fushat e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Një tjetër problematikë e konstatuar nga Zyra e Komisionerit është se bazuar në nenin 474 të Kodit të Procedurës Civile, rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në Gjykatën e Lartë nënshkruhen nga avokati që e përfaqëson palën dhe, nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.

Si rezultat i zbatimit të kësaj dispozite, Zyra e Komisionerit e gjen veten në pamundësi përfaqësimi pranë Gjykatës së Lartë për shkak se, në një numër të madh të rasteve, ajo ndodhet në gjykim përballë autoriteteve publike dhe në këto raste, këto përfaqësohen nga Avokatura e Shtetit. Ndodhur në këto kushte, kjo e fundit është në pamundësi për të përfaqësuar edhe Zyrën e Komisionerit.

Nga ana tjetër, angazhimi i një avokati paraqet problematika të natyrës qoftë administrative, por edhe përmbajtësore. Kjo për shkakun se angazhimi i tij do të duhet të kryhej mbi bazën e një procedure prokurimi publik, dhe nga ana tjetër, angazhimi i një profesionisti jashtë Zyrës së Komisionerit do të vinte në pikëpyetje mbrojtjen e të drejtës objekt i rekursit, për shkak të natyrës së ligjeve të posaçme që ka në objektin e veprimtarisë së saj Zyra e Komisionerit, të cilat janë të një natyre specifike, dhe jo çdo avokat mund të jetë i pajisur me njohuritë e posaçme që ato kërkojnë.

Në disa raste jemi ndodhur përpara faktit kur institucione të tjera palë në të njëjtin gjykim me ne, janë lejuar të përfaqësojnë interesat e tyre në gjykim për shkak të cilësive të veçanta, ndërkohë që të njëjtat cilësi të veçanta (pasur parasysh karakteri specifik i njohurive që kërkon puna pranë Zyrës së Komisionerit), nuk i janë njohur kësaj të fundit.

Pika 1, germa e) e nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i ka dhënë Komisionerit të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ky qëndrim i Gjykatës së Lartë vlerësojmë se nuk vjen në linjë me qasjen e Kushtetutës.

Për këtë arsye, mendojmë se kjo çështje mund të zgjidhet duke kryer ndërhyrje legjislative me qëllim adresimin e problematikës për institucionin tonë, por edhe për institucione të tjera të cilat mund të ndodhen në të njëjtën situatë pamundësie.

IX. MENAXHIMI BUXHETOR

IX.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Objektivi strategjik i Zyrës së Komisionerit, parashikuar edhe në strategjinë institucionale 2022-2025, ka qenë jo vetëm përafrimi i kuadrit ligjor në fuqi me *acquis communitaire*, por edhe përfarimi dhe përshtatja e funksioneve organizative me modelin e institucioneve homologe të vendeve të BE-së.

Kuvendi i Republikës të Shqipërisë ka miratuar me Vendimin nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, strukturën dhe organigramën e Zyrës së Komisionerit. Ky Vendim është bërë i zbatueshëm më datë 1 Janar 2024, pas miratimit të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”.

Gjatë vitit 2024, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive të përmbajtjes, referuar planit vjetor të rekrutimeve 2024, janë realizuar 8 procedura rekrutimi (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil) konform kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Zyra e Komisionerit ka treguar vëmendje të veçantë sa i përket zhvillimit të trajnimeve për stafin, me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e performancës së çdo nëpunësi civil.

Struktura e Zyrës së Komisionerit mbetet e paplotësuar për shkak se kërkesat e paraqitura në PBA për numrin e punonjësve nuk janë reflektuar. Kjo mungesë sjell pamundësinë e ushtrimit të disa funksioneve nga Zyra e Komisionerit.

IX.2 MENAXHIMI I BUXHETIT

Me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” të ndryshuar, dhe akteve administrative në zbatim të tyre, fondet e akorduara për Zyrën e Komisionerit ishin në vlerën 168.950 (në mijë) lekë. Buxheti i Zyrës së Komisionerit, për vitin 2024, me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, konkludon të jetë në vlerën totale prej 160.055 (në mijë) lekë. Në kuadër të pavarësisë së menaxhimit të buxhetit, por edhe në zbatim të transparencës mbi përdorimin e fondeve buxhetore, në tabelën e mëposhtme pasqyrohet në %, çdo kategori shpenzimesh, përkundrejt totalit të buxhetit, si dhe niveli i realizimit të fondeve buxhetore të Zyrës së Komisionerit në % dhe vlerë, për secilën kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

| Nr. | Emërtimi | Plani vjetor 2024 (i ndryshuar) | Struktura në përqindje kundrejt totalit | Fakti vjetor | % realizimi kundrejt planit vjetor për kategori |
|-----|--|---------------------------------------|---|-----------------|--|
| 1 | Paga | 92.140 | 57.5 % | 91.651 | 99.2 % |
| 2 | Sigurime shoqërore | 16.330 | 10.2 % | 14.413 | 88.2 % |
| 3 | Mallra e shërbime të tjera | 32.790 | 20.5 % | 31.089 | 94.8 % |
| 4 | Investime | 18.000 | 11.2 % | 16.362 | 90.9 % |
| 5 | Transferta te buxhetet familjare | 310 | 0.2 % | 287 | 92.5 % |
| 6 | Kuotizacion | 130 | 0.08 % | 111 | 85.3 % |
| 7 | Fondi i vecantë | 355 | 0.2 % | 291 | 81.9 |
| | Totali | 160.055 | | 154.204 | 96.3 % |

Fondet e vëna në dispozicion të Zyrës së Komisionerit, janë realizuar në shumën gjithsej prej 154.204 (në mijë) lekë, ose në nivelin 96.3% ndaj planit të miratuar. Përvoja e suksesshme me realizimin e buxhetit edhe për vitin 2024, është një tregues i rëndësishëm për mirëmenaxhimin e fondeve buxhetore dhe tregon që planifikimi vjetor dhe administrimi është bërë me kujdes.

IX.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET

Për vitin 2024 sanksionet administrative të vendosura, janë në shumën 4 180 000 lekë. Ekzekutimi i sanksioneve arkëtohet 100% në buxhetin e shtetit, duke u shlyer vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përbarimor.

| Totali i sanksioneve në vitin 2024 | 4 180 000 |
|--|-----------|
| Për shkelje të dispozitave ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale | 3 680 000 |
| Për shkelje të dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit | 500 000 |

Për vitin 2024, shuma totale e arkëtimit të sanksioneve administrative është 1 565 000 lekë, e cila ndahet në 190 000 lekë për sanksionet e vendosur në vitin 2024 dhe vlera 1 375 000 lekë për sanksionet e mbartura nga vitet paraardhëse.

IX.4 AUDITIME

Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë e programit të auditimit nga disa institucione monitoruese/mbikëqyrëse mbi zbatueshmërinë e legjislacioneve specifike të fushave të tyre të përgjegjësisë ku përmendim:

- Auditimi i ushtruar nga Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, me objekt *“Zbatueshmëria e legjislacionit të shërbimit civil”* për një periudhë 10 vjeçare;
- Auditimi i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me objekt *“Auditimin financiar dhe Përputhshmërie”* për një periudhë 3 vjeçare;
- Auditimi i ushtruar nga Ministria e Financave, struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Harominizimit dhe Kontrollit Financiar, me objekt *“Mbi veprimtarinë e zbatimit të cilësisë së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”*;
- Auditimi i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike me objekt *“Vlerësimin e dobësive të sigurisë kibernetike në Zyrën e Komisionerit”*;
- Auditimi i ushtruar nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me objekt *“Zbatimin e detyrave në sekretari- arkiv”*.

Pas çdo auditimi/inspektimi të kryer, veç vlerësimeve pozitive, janë lënë rekomandime dhe detyra konkrete. Zyra e Komisionerit është angazhuar për planifikimin e masave me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2024, Zyra e Komisionerit ka konstatuar edhe një praktikë të dublimit të funksioneve të saj nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si pjesë e fushës së veprimtarisë së tij: *“Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon në*

përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualët në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Auditimi mbulon fushat e përputhshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë, menaxhimit financiar, kontabilitetit, si dhe ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t.”

Në bazë të nenit 110 të ligjit të mësipërm, kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit përfshijnë:

- a) *auditimin e zbatimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë llogaritë vjetore të buxhetit;*
- b) *auditimin e mbledhjes së të ardhurave publike;*
- c) *auditimin e përdorimit, administrimit dhe mbrojtjes së fondeve publike dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;*
- ç) *auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e opinionit për to; d) auditimin e sistemeve të auditimit të brendshëm të sektorit publik;*
- dh) *auditimin e përdoruesve të fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Europian ose organizata të tjera ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe me ligj të veçantë;*
- e) *auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike dhe financiarë të Shtetit në personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;*
- ë) *auditimin, me qëllim mbrojtjen e interesave publikë, në veprimtaritë apo sektorët e rregulluar me kontrata koncesionare;*
- f) *auditimin e partive politike, enteve publike apo shoqatave për fondet që u janë akorduar atyre nga Buxheti i Shtetit;*
- g) *auditimin e subjekteve të tjera, të përcaktuara në ligje të veçanta.*

Siç mund të konstatohet nga një analizë e dispozitave të mësipërme, kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit konsistojnë në auditimin financiar duke u fokusuar në mënyrën e përdorimit të fondeve publike me qëllim garantimin e përdorimit të tyre me efikasitet dhe në interesin më të lartë të shtetit në shërbim të qytetarit.

Megjithatë, nisur nga shqetësime që na kanë mbërritur përfshirë edhe organizata të shoqërisë civile të angazhuara në projekte me fokus forcimin e transparencës së organeve të vetëqeverisjes vendore, është konstatuar një tendencë e institucionit të KLSH, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij sipas ligjit të tij material, për t’u mbivendosur ndaj kompetencave dhe detyrave që me LDI apo me ligjin nr. 124/2024 (i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 9887/2008) i janë besuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Konkretisht, sipas shqetësimit të përcjellë, konstatohet se në objektin e auditimit të KLSH është përfshirë edhe përputhshmëria e programit të transparencës me LDI.

Kujtojmë që instrumenti i programit të transparencës rregullohet nga neni 7 i LDI dhe në bazë të nenit 9/1 të po këtij ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Në funksion të kësaj kompetence, bazuar në germën c të nenit 9/1 Komisioneri: ... c) *kryen hetim administrativ kryesisht ose me ankesë gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;*

Pra, hetimi administrativ lidhur me formatin dhe përmbajtjen e instrumentit të programit të transparencës është kompetencë që nga ligji i posaçëm i është veshur Komisionerit dhe mbivendosja e kësaj kompetence nga institucione të tjera, jo vetëm cenon parimin e luajalitetit institucional dhe kushtetues por edhe krijon pasiguri juridike tek autoritetet publike të cilat janë objekt i LDI.

Më tej, ka rezultuar nga eksperiencia praktike e Zyrës së Komisionerit, që në kuadër të ushtrimit të auditit të performancës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në tejkallim të parashikimeve të neneve 6 dhe 10 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, hyn në thelb të çështjeve konkrete të trajtuara nga Zyra e Komisionerit, duke kryer vlerësim të mënyrës së ushtrimit të funksioneve që i janë besuar Komisionerit sipas ligjeve të posaçme të përmendura në paragrafët më sipër.

Bazuar në pikën 2 të nenit 82 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri harton një raport vjetor dhe raporton përpara Kuvendit sa herë i kërkohet, si dhe i kërkon atij të dëgjohet për çështje të rëndësishme.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit mbështet dhe mirëpret ushtrimin e detyrave dhe kompetencave nga institucionet e tjera, qofshin këto të pavarura apo pjesë e pushtetit ekzekutiv. Megjithatë, siç mund të keni qenë dëshmitarë gjatë procesit të miratimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të hyrë rishtazi në fuqi (ku edhe rregullohet statusi i Zyrës), nga organizmat ndërkombëtarë të cilat monitorojnë progresin e vendit tonë drejt BE, i është vënë një theks i posaçëm pavarësisë së institucionit dhe mbrojtjes së tij nga çdo situatë cenimi të pavarësisë së përcaktuar me ligj.



Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, Tiranë
Tel: +355 42237200 | www.idp.al